

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: AGROEKONOMI

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë

Mentori:

Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj

Kandidati/ja:

Blerta Vehapi

Prishtinë, 2021

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “ HASAN PRISHTINA”

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: AGROEKONOMI

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë

Mentori/ja:

Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj

Kandidati/ja:

Blerta Vehapi

Prishtinë, 2021

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.

Deklaratë për punimin

Unë Blerta Vehapi, i/e lindur më datë 30.09.1997 në Lipjan si student i masterit në Departamentin e “AGROEKONOMISË”, para mbrojtjes së punimit të masterit, nën përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punim i masterit me titull: **Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë** është rezultat i punës origjinale dhe e bërë personalisht nga vet unë. Asnjë pjesë e këtij punimi nuk është marr nga dikush tjetër pa qenë e cituar sipas standardeve të citimit. Një hulumtim i tillë nuk është prezantuar apo botuar para një institucioni më parë. Ky hulumtim është dizajnuar duke u bazuar në literaturën dhe burimet e cituara në punim. Andaj vetëm unë mbajë përgjegjësi personale deri në anulim të titullit të fituar në bazë të mbrojtjes së këtij punimi. Përgjegjësi për plagjiaturë në asnjë formë nuk mbajnë institucioni dhe anëtarët e komisionit.

Deklaratën e nënshkruaj në prezencë të personit zyrtar.

Prishtinë,

Datë _____

Nënshkrimi i kandidatit/es _____

PËRMBAJTJA

FALENDERIME	IV
ABSTRAKTI	V
ABSTRACT	VI
LISTA E FIGURAVE	VII
LISTA E TABELAVE	VIII
KAPITULLI 1: HYRJE	1
1.1 Sfondi i studimit dhe arsyeshmëria e temës	1
1.2 Objektivat	2
1.3 Pyetjet dhe hipotezat hulumtuese.....	2
1.3.1 Hipotezat	2
1.3.2 Pyetjet hulumtuese.....	3
1.4 Rezultatet e pritshme	3
1.5 Kufizimet e punimit.....	4
1.6 Struktura e punimit.....	4
KAPITULLI 2: RISHIKIMI MBI LITERATURËN E FUSHËS	5
1.2 Sektori i bujqësisë në Kosovë	5
2.2 Termi “Zinxhir i vlerës”	6
2.3 Marrdhëniet brenda zinxhirit të vlerës	9
2.4 Rëndësia e studimit të zinxhirit të vlerës	10
2.5 Sektori i pemëve të imëta në Kosovë.....	13
2.6 Zinxhiri i vlerës në Kosovë dhe te sektori i pemëve të imëta	17
2.7 Ndikimi i politikave në zinxhirë të vlerës	21
KAPITULLI 3: METODOLOGJIA DHE METODAT E HULUMTIMIT	24
3.1 Metodologjia e aplikuar	24
3.1.1. Informata lidhur me pyetësorin	25
KAPITULLI 4: REZULTATE DHE DISKUTIME	27
4.1 Vlerësimi dhe kontrollueshmëria e faktorit.....	27
4.1.1 Tregu ndërkombëtar	27
4.1.2 Kultura.....	29
4.1.3 Pajisjet	31

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

4.1.4 Inputet.....	33
4.1.5 Fuqia punëtore.....	35
4.1.6 Struktura e tregut.....	36
4.1.7 Menaxhimi në fermë.....	37
4.1.8 Makroekonomia.....	39
4.1.9 Rregullativat e sigurisë ushqimore.....	41
4.1.10 Inspektimi.....	42
4.1.11 Koordinimi i zinxhirit	43
4.2 Vërtetimi i hipotezave.....	44
KAPITULLI 5 : PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	53
5.1 Përfundime	53
5.2 Rekomandime	55
LITERATURA	56
ANEKS	59

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

FALENDERIME

Mbështetja e shumë personave gjatë kryerjes së këtij studimi ka qenë shumë domethënëse për mua. Nuk do të kishe qenë kaq e lehtë pa ndihmën e tyre.

Fillimisht, një falenderim i dedikohet mentorit tim, Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj, i cili ka qenë gjatë gjithë kohës udhërrëfyes për kryerjen e hulumtimit të mëposhtëm. Ndihma dhe besimi që më dha ishin një shtytje tejet e rëndësishme për finalizimin e këtij hulumtimi me sukses.

Bashkëpunimi dhe ndarja e ideve me koleget të cilat i falenderoj përzemërsisht, dha një kontribut të madh në kryerjen e një studimi sa më të mirë. Falenderoj gjithashtu, të gjithë të intervistuarit që më ndihmuan gjatë punës në teren, pa të cilët ky studim nuk do të arrinte qëllimin.

Dhe më e rëndësishmja, falenderim i veçantë shkon për familjen time, pa mbështetjen e të cilëve nuk do ta arrija këtë sukses.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij studimi ka qenë analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës tek mjedra dhe dredhëza. Studimi synon të adresojë një sërë objektivash dhe pyetjesh kërkimore nga të dhënat primare dhe sekondare, rreth funksionimit të zinxhirit të vlerës. Të dhënat sekondare shërbyen për njohjen e funksionimit të zinxhirit si dhe njohjen e natyrës së marrdhënieve mes akterëve të përfshirë në të.

Të dhënat primare janë siguruar përmes intervistave të realizuara në teren. Pyetëtori përfshinë gjithsej 13 faktorë, kështu duke ngërthyer të gjitha hallkat e zinxhirit të vlerës, nga prodhimi deri tek shitja. Gjithsej janë realizuar 24 intervista me ekspertë të fushës, profesorë, përfaqësues të organizatave, barnatore bujqësore dhe pika grumbulluese.

Studimi i kryer do të pasqyrojë analizimin e performancës së zinxhirit të vlerës, mundësitë, kufizimet dhe sfidat që karakterizojnë atë dhe në fund ofrimi i rekomandimeve se si ato mund të trajtohen drejt një performace edhe më të mirë.

Fjalët kyqe: zinxhiri i vlerës, faktorët, mjedra, dredhëza, performanca

ABSTRACT

The purpose of this study was to analyze the performance of value chain in raspberry and strawberry. The study aims to address a range of objectives and research questions from primary and secondary data about value chain functioning. The secondary data served to recognize the functioning of the chain as well as the nature of the relationships between the actors involved in it.

Primary data were provided through field interviews. The questionnaire includes a total of 13 factors, thus intertwining all the links of the value chain from production to sales. A total of 24 interviews were conducted with experts of the field, professors, representatives of organizations, agricultural pharmacies and raspberry and strawberry collection points.

The study conducted will reflect the analysis of value chain performance, opportunities, constraints and challenges that characterize it and finally provide recommendations on how they can be addressed towards an even better performance.

Keywords: value chain, factors, raspberry, strawberry, performance

LISTA E FIGURAVE

Kapitulli 2

Figura 1 Sipërfaqja e kultivuar me dredhëz 2015-2019	14
Figura 2 Sipërfaqja e kultivuar me mjedër në ha, 2012-2018.....	16
Figura 3 Zinxhiri i vlerës tek sektori i pemëve të imëta në Kosovë.....	19

Kapitulli 3

Figura 1: Faktorët e përfshirë në pyetësor	26
--	----

Kapitulli 4

Figura 1: Vlerësimi i faktorit “Tregu ndërkombëtar”	27
Figura 2 Vlerësimi i faktorit “ Kultura”	29
Figura 3: Vlerësimi i faktorit “Pajisjet”	32
Figura 4: Vlerësimi i faktorit “Inputet”	33
Figura 5: Vlerësimi i faktorit “Fuqia punëtore”.....	35
Figura 6: Vlerësimi i faktorit “ Struktura e tregut”.....	36
Figura 7: Vlerësimi i faktorit “ Menaxhimi në fermë”	37
Figura 8: Vlerësimi i faktorit “Makroekonomia”	39
Figura 9: Vlerësimi i faktorit “ Rregullativat e sigurisë ushqimore”	41
Figura 10: Vlerësimi i faktorit “ Inspektimi”	42
Figura 11: Vlerësimi i faktorit “ Koordinimi i zinxhirit”	43
Figura 12: Relevanca për nënfaktorët “ inputet, menaxhimi në fermë dhe koordinimi i zinxhirit”	45
Figura 13: Relevanca tek faktori “ Politikat bujqësore”	49

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

LISTA E TABELAVE

Kapitulli 4

Tabela 1: Analizimi i hipotezës së dytë me T-test.....	46
Tabela 2 Testimi i hipotezës së dytë me T-test.....	47
Tabela 3: Testimi i hipotezës së tretë me T-test.....	50
Tabela 4: Testimi i hipotezës së katërt me T-test.....	51

KAPITULLI 1: HYRJJE

1.1 Sfondi i studimit dhe arsyeshmëria e temës

Kosova ka një traditë të lashtë në kultivimin e kulturave pemëtare si molla, dardha, kumbulla, qershia, vishnja, lajthia, dredhëza, mjedra, manaferra etj. Në periudhën e kaluar prodhimtaria pemëtare në Kosovë u karakterizua nga shumëllojshmëria e kultivarëve të vjetërsuar dhe jo shumë produktiv, mbjelljeve të pemishteve ekstensive e gjysmë-intensive me material fidanor jo kualitativ, niveli i ulët i aplikimit të masave agropomoteknike, praktika jo adekuate të menaxhimit shkencor bujqësor dhe mungesa e objekteve adekuate për ruajtjen e frutave (ASK, 2017).

Dredhëza është e destinuar për tregun e brendshëm edhe pse ka një trend të rënies në prodhimin e tyre. Kërkesa e brendshme e dredhëzës ka qenë në vazhdimësi në rritje e mbuluar nga importet, që përbëjnë rreth 40% të furnizimit të përgjithshëm. Prodhuesit rajonal të dredhëzës janë mjaft konkurrenues. Ky mjedis është mjaft sfidues për prodhuesit vendas. Gjithashtu prodhuesit aktualisht e shohin mjedrën si një opsion më të mirë për kultivim (Miftari, I., 2016).

Kultivimi i mjedrës u prezantua kohëve të fundit nga projektet e zhvillimit dhe kultivimi i saj është i destinuar kryesisht për eksport. Prodhimi është i vogël por në rritje dhe deri më tani ka sukses në gjetjen e tregjeve. Prodhuesit janë të interesuar për shkak të mundësive të mira të tregut të ofruara deri më tani nga produkti (Miftari, I., 2016).

Sipas (ASK, 2017), vitet e fundit janë duke u rritur sipërfaqet e mbjellura me pemishte intensive, me shumëllojshmëri të kultivarëve dhe nënshartesave bashkëkohore, duke aplikuar nivel të lartë të teknologjisë së prodhimit. Me gjithë kushtet e volitshme dhe traditës për kultivimin e pemëve që ka Kosova, statistikatat bujqësore tregojnë se ngritja e pemishteve dhe prodhimtaria pemëtare nuk është ende në atë nivel me të cilin janë mundësitë dhe potenciali agroekologjik.

Meqenëse, struktura e fermave në Kosovë është struktura e fermave të vogla, ku prodhimet kultivohen në parcela tejet të vogla atëherë potenciali për zhvillim i sektorit shihet në kultivimin

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

e prodhimeve me vlera të larta. Mjedra dhe dredhëza janë nga kulturat të cilat edhe pse në sipërfaqe modeste arrijnë të sigurojnë të ardhura të larta dhe kthim të shpejtë të investimeve.

Se egziston nevoja për intervenim është mjaft e dukshme. Prandaj, qëllimi i këtij hulumtimi është të studiohet performanca e zinxhirit të vlerës për gjetjen dhe identifikimin e shkaqeve për ngecje të vazhdueshme të vlerës zinxhimore. Dhe, pas analizimit të gjendjes të jepen mundësi për përmirësime aty ku është e nevojshme.

1.2 Objektivat

Objektivi kryesor

- Përmirësimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta përmes analizimit të faktorëve pjesëmarrës në zinxhirin e vlerës

Objektivat specifik

- Identifikimi i faktorëve që ndikojnë në performancën aktuale të zinxhirit të vlerës
- Vlerësimi mbi rëndësinë e secilës hallkë të zinxhirit të vlerës
- Analiza e koordinimit horizontal dhe vertikal
- Hulumtimi mbi ndikimin e “Mjedisit të përshtatshëm”
- Dhënia e rekomandimeve nga rezultatet që do të nxirren

1.3 Pyetjet dhe hipotezat hulumtuese

1.3.1 Hipotezat

1. Zinxhiri i vlerës funksionon më mirë te mjedra sesa tek dredhëza
2. Koordinimi vertikal dhe horizontal kanë ndikim pozitiv në performancën e zinxhirit të vlerës
3. Politikat bujqësore ndikojnë pozitivisht në performancën e zinxhirit
4. Teknologjia e përdorur në vend, ndikon në prodhimtarinë e mjedrës dhe të dredhëzës

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

1.3.2 Pyetjet hulumtuese

Disa nga pyetjet hulumtuese janë:

1. Si e vlerësojnë ekspertët kontrollueshmërinë, relevancën dhe peshën e tregut ndërkombëtar në performancën e zinxhirit të vlerës?
2. Specifikoni kontributin pozitiv apo negativ të nënfaktorëve në performancën e zinxhirit të vlerës?
3. Peshojeni aftësinë e secilit nënfaktorë me të cilën ndikon në performancën e faktorit kryesor?
4. Cili është ndikimi i rregullativave të sigurisë ushqimore dhe inspektimit?
5. Sa mirë është i harmonizuar zinxhiri i vlerës përmes koordinimit horizontal dhe vertikal?
6. Cili faktor ambiental ndikon më shumë në përmirësimin e kësaj performance?
7. Cfarë roli kanë pajisjet, inputet dhe kualifikimi i fuqisë punëtore në këtë zinxhir?
8. Cila është rëndësia e menaxhimit në fermë\kompani në këtë çështje?
9. Ku funksionon më mirë zinxhiri i vlerës, tek mjedra apo tek dredhëza?

1.4 Rezultatet e pritshme

Nga ky hulumtim ne presim të nxirren rezultate që na pasqyrojnë gjendjen dhe rëndësinë e funksionimit të zinxhirit të vlerës. Pastaj, nga faktorët e përfshirë të shihet se cilat janë pikat ku kemi ngecje, rrugë kjo e cila shpie drejt përmirësimit të performancës së zinxhirit të vlerës.

E dhënë tjetër e rëndësishme që pritet të dal nga ky studim është matja e peshës dhe rëndësisë së faktorëve tek zinxhiri i vlerës së mjedrës dhe dredhëzës. Si dhe mënyrën e koordinimit të akterëve të përfshirë në të.

Dhe në fund, nga të dhënat e fituara presim që të arrihet përmbushja e qëllimit kryesor dhe arritja e objektivave.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

1.5 Kufizimet e punimit

Punimi është i bazuar edhe në të dhëna sekondare ku është bërë shqyrtimi i literaturës. Të dhënat rreth hulumtimeve të zinxhirit të vlerës kryesisht konsistojnë që janë bërë shumë vite më herët. Pak gjejmë hulumtime të kohëve të fundit.

Hulumtimi është i përqendruar kryesisht në rajonin e Prishtinës dhe të Ferizajit. Arsyeja për këtë është se këto dy rajone janë kultivuesit më të mëdhenjë të kulturës së mjedrës dhe të dredhëzës. Kështu që hulumtimi kufizohet në aspektin e mospërfshirjes së të dhënave të tërë teritorit të Kosovës.

1.6 Struktura e punimit

Punimi në fjalë organizohet në pesë kapituj:

Kapitulli i parë përmban hyrjen, në të cilën përfshihen sfondi i studimit, arsyeshmëria e temës. Pastaj, ky kapitull na njofton me objektivat e punimit, pyetjet hulumtuese hipotezat dhe pritshmëritë e punimit.

Kapitulli i dytë përbën rishikimin e literaturës, në të cilin është bërë një konsultim i gjerë dhe i hollshëm i materialeve që janë bërë deri sot lidhur me zinxhirin e vlerës tek sektori i pemëve të imëta, përkatësisht tek mjedra dhe dredhëza.

Kapitulli i tretë shpreh të gjitha metodat dhe mjetet e përdorura apo rrugën e zgjedhur, identifikimin dhe analizimin e informacioneve të nevojshme për hulumtim.

Kapitulli i katërt përmban analizën dhe diskutimin e rezultateve të hulumtimit

Kapitulli i pestë pasqyron përmbledhjen e shkurtë të rezultateve, dhe rekomandimet që janë arritur të nxirren nga hulumtimi në teren.

KAPITULLI 2: RISHIKIMI MBI LITERATURËN E FUSHËS

2.1 Sektori i bujqësisë në Kosovë

Sipërfaqja e përgjithshme e Kosovës është 1.1 milion hektarë, ku 53% e përbëjnë tokë bujqësore ndërsa 41% është pylltari (Gjokaj, E. Halimi, K. Gjonbalaj, M. Leeds, S., 2017), kontributi i sektorit të bujqësisë në Bruto Produktin Vendor është rreth 11 përqind, 60 përqind e popullsisë së Kosovës jeton në zonat rurale. Të dy treguesit zvogëlohen ngadalë duke treguar se: sektorët e tjerë ekonomikë po zhvillohen më shpejtë se bujqësia dhe pavarësisht nga rritja e lartë e popullsisë, migrimi në zonat urbane dhe migrimi në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera është ende opsioni i preferuar për shumë prej banorëve rurale (Gjokaj, E, Gjonbalaj, M, Halimi, K, Leeds, S., 2018), disa nga problemet me të cilat përballen fermerët e Kosovës janë mungesa e koordinimit ndërmjet fermerëve të vegjël, mungesa e arsimit dhe trajnimit, njohuritë e kufizuara në përdorimin e teknologjisë, shërbimi kundërshtar, mungesa e përvojës, qasja e kufizuar në treg dhe shqetësimi kryesor është mungesa e bashkëpunimit midis fermerëve (Muriqi, M., Fekrete-Farkas, M., Baranya, Z., 2019).

Kosova ka qenë një zonë për rritjen e frutave të pemëve për shekuj duke përfituar nga kushtet e favorshme agro klimatike si dhe nga varietetet tradicionale me rezistencë të mirë ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve. Baza e një industrie moderne tregtare u krijua në vitin 1957 me futjen e varieteteve të reja dhe teknikave të kultivimi, deri në vitin 1984 mbi 12,000 ha ishin në prodhim nga të cilat 84% ishin në pronësi private. Mollët ishin dominuese, të pasuara nga kumbullat, dardhat, qershitë dhe arrat (MBPZHR, 2009).

Sipas (Gjokaj, E, Gjonbalaj, M, Halimi, K, Leeds, S., 2018), sektori është i dominuar nga fermerë të vegjël (që zotërojnë nga 0,5 në 5 hektarë tokë), dhe kjo situatë nuk pritet të ndryshojë në të ardhmen e afërt. Bujqësia aktualisht kontribuon me 18 përqind të eksporteve të Kosovës, nga 15 përqind sa ishte regjistruar në 2016. Përvoja e fundit me frutat e buta tregon një potencial të madh zgjerimi në prodhimin e kulturave me vlera të larta duke përdorur strukturën ekzistuese të pronarëve të vegjël, duke synuar prodhimin në shkallë mikro, të vogël dhe të mesme në parcela deri në 5 hektarë tokë, e cila në vitin 2016 përfaqësonte 94.2 përqind të të gjitha

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

zotërimeve të tokës. Përpjekjet për të nxitur rritjen e sektorit agro-sektorial duhet të përqendrohen më tej në fermat midis 1 dhe 5 hektarësh. Zgjerimi do të vijë nga një transformim nga drithërat në kultura me vlera më të larta. Meqenëse, vetëm 10 përqind e tokës së punueshme të Kosovës përdoret për prodhimin me vlera më të larta të frutave, perimeve dhe rrushit të verës, ka qartë potencial për t'u zgjeruar.

Kosova nuk është një qendër e rëndësishme bujqësore, prodhimi, përpunimi dhe tregtia janë përqendruar kryesisht në konsumin, ekzistencën lokale. Zinxhirët e tij të vlerës janë të kufizuar dhe ofrimi i shërbimeve kufizohet nga burime të kufizuara (Bajramović, S., Bogdanov, J., Butkovic, J., Dimitrievski, D., Erjavec, E., Gjenci, G., Hoxha, B., Janeska, I., Konjevic, D., Kotevska, A., Matrinovic, A., Miftari, I., etj., 2016).

Konkurrenca rajonale në produkte madhore thjeshtë nuk e favorizon Kosovën duke pasur parasysh disavantazhet e saj. Përveç, nëse zonat rurale të Kosovës bëhen më dinamike dhe inovative, ekziston një rrezik i madh që këta fermerë, të cilët janë potencialisht fitimprurës, do të humbasin nga importet, dhe se fermerët e vegjël do të mbeten të zhytur në varfëri. Duke vepruar vetëm si një zbutës i punësimit, sektori i bujqësisë në Kosovë nuk është në gjendje të realizojë potencialin e vet si një sektor dinamik ekonomik. Në këtë kontekst fokusi duhet të jetë në zëvendësimin e importit dhe eksportit me prodhimet me vlerë të lartë (EFSE, Europe, European fund for southeast Europe).

2.2 Termi “Zinxhir i vlerës”

Zinxhiri i vlerës përshkruan gamën e plotë të aktiviteteve që firmat dhe punëtorët kryejnë për të sjellë një produkt nga konceptimi i tij në përdorimin përfundimtar dhe më gjerë. Kjo përfshinë aktivitete të tilla si dizajni, prodhimi, tregtimi, shpërndarja dhe mbështetja për konsumatorin përfundimtar. Aktivitetet që përmbajnë një zinxhir vlerash mund të përmbahen brenda një firme të vetme ose të ndara midis firmave të ndryshme (Trienekens H, 2011).

Një zinxhir i qëndrueshëm i vlerës ushqimore përcaktohet si: gamë e plotë e fermave, firmave dhe aktiviteteve të tyre të njëpasnjëshme të koordinuar të vlerës së shtuar që prodhojnë materiale

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

të veçanta të papërpunuara bujqësore dhe i transformojnë ato në produkte të veçanta ushqimore që shiten te konsumatorët përfundimtar dhe të asgjësuar pas përdorimit në një mënyrë që është fitimprurëse për të gjithë, ku përfitimet me bazë të gjerë për shoqërinë dhe nuk i shteron përgjithmonë burimet natyrore (David Neven, 2014).

Sipas (Kaplinsky, R.), analiza e zinxhirit të vlerës hedh më shumë dritë mbi përcaktuesit e shpërndarjes së të ardhurave si brenda dhe midis vendeve sesa një analizë e industrisë tradicionale.

Zinxhirët e vlerës janë: të nxitur nga kërkesa e konsumatorit drejtuar brenda kornizës së ligjeve lokale kombëtare dhe zakoneve lokale, menaxhuar nga njerëzit në zinxhir të cilët vendosin rregulla se si njerëzit ndërveprojnë, prodhojnë dhe transportojnë një mall (FAO, Food and Agricultural Organization, 2011).

Zinxhirët e vlerës janë një mënyrë për të kuptuar ndërveprimin e njerëzve dhe firmave me tregjet qofshin ato vendase apo globale. Në zinxhirët e vlerës aktorët kryesorë kryejnë një përzgjedhje të funksioneve parësore. Këto zakonisht përfshijnë furnizimin me input, prodhimin, përpunimin, magazinimin, shitjen me shumicë (përfshirë eksportin), shitjen me pakicë dhe konsumin. Aktorët që kryejnë funksione të ngjashme konsiderohet se zënë të njëjtën "nyje" funksionale, për shembull nyjen e furnizimit të hyrjes, nyjen e prodhimit, nyjen me pakicë etj. Aktorët sekondarë ose punëtorët ndihmës, kryejnë role apo shërbime sekondare që mbështesin funksionet kryesore të tilla si përpunimi i transportit, ndërmjetësimi dhe shërbimi. Meqenëse mallrat në zinxhirët e vlerës shkëmbehen dhe transformohen ato lëvizin në drejtim të rrjedhës së një serie transaksionesh që shtojnë vlerë dhe kosto (Mitchell, J., Keane, J., Coles, Ch., 2009).

Nga analizat e bëra tek zinxhiri i vlerës (Kumar, D., Rajeev, P.V., 2016), rrjedh se zinxhiri i vlerës përqendrohet kryesisht në strategjinë e bashkëpunimit të tregut ku thekson lidhjet midis aktiviteteve të prodhimit, marketingut të produkteve dhe shërbimeve në një mënyrë efektive dhe efikase.

Koncepti i zinxhirit të vlerës ka disa dimensione. E para është rrjedha e saj, e quajtur edhe struktura e saj input-output. Në këtë kuptim një zinxhir është një grup i produkteve dhe shërbimeve të lidhura së bashku në një sekuencë të aktiviteteve ekonomike me vlerë të shtuar.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Një zinxhir vlerash ka një strukturë tjetër më pak të dukshme. Kjo përbëhet nga rrjedha e njohurive dhe ekspertizës së nevojshme për funksionimin e strukturës fizike input-output. Rrjedha e njohurive paralelisht rrjedhë me rrjedhat e materialit por intensiteti i saj mund të ndryshojë. Dimensioni i dytë i një zinxhiri vlera ka të bëjë me përhapjen e tij gjeografike. Disa zinxhirë janë vërtet global me aktivitete që zhvillohen në shumë vende në kontinente të ndryshme. Të tjerët janë më të kufizuar, duke përfshirë vetëm disa vende në pjesë të ndryshme të botës. Dimensioni i tretë i zinxhirit të vlerës është kontrolli që aktorë të ndryshëm mund të ushtrojnë mbi aktivitetet që përbëjnë zinxhirin. Aktorët në një zinxhir kontrollojnë drejtpërdrejtë aktivitetet e tyre dhe kontrollohen direkt ose indirekt nga aktorë të tjerë. Meqenëse zinxhirët e vlerave janë në thelb yje të bashkëveprimit njerëzor varietetet e mundshme të qeverisjes janë të pafundme (University of Cambridge, 2020).

Zinxhiri i vlerës së një firme formon një pjesë të një rryme më të madhe të aktiviteteve të cilën Porter e quan një sistem vlerash. Një sistem vlerash ose një zinxhir i vlerës së industrisë përfshinë furnizuesit që ofrojnë inputet e nevojshme për firmën së bashku me zinxhirët e tyre të vlerës. Pasi firma krijon produkte, këto produkte kalojnë nëpër zinxhirët e vlerave të shpërndarësve (të cilët gjithashtu kanë zinxhirët e tyre të vlerës), deri te klientët. Të gjitha pjesët e këtyre zinxhirëve përfshihen në sistemin e vlerës. Për të arritur dhe mbështetur një avantazh konkurrues dhe për ta mbështetur atë përparësi me teknologjitë e informacionit një firmë duhet të kuptojë çdo përbërës të këtij sistemi vlerash (Porter, M.).

Në realitet zinxhirët e vlerës janë shumë kompleks. Shumë furnizime hyrëse përdoren në nivele të ndryshme të zinxhirit. Për shembull, farat dhe plehrat përdoren në prodhimin e lëndëve të para bujqësore; makineritë dhe materiali i paketimit përdoren në prodhimin e produkteve ushqimore. Për më tepër lëndët e para bujqësore mund të përpunohen në një larmi të madhe të produkteve ushqimore dhe rezultatet në nivele të ndryshme të zinxhirit mund të rrjedhin në disa zinxhirë të tjerë. Prandaj, është thelbësore që analiza e zinxhirit të vlerës të përcaktojë qartë qëllimin e analizës. Një zinxhir vlerash mund të konsiderohet si një pemë me shumë degë. Qëllimi do të përcaktojë pjesët që do të merren parasysh gjatë analizës (produktet kryesore të zinxhirit dhe mbulimi gjeografik i tij). Analiza e zinxhirëve të vlerave ka nevojë për një fokus të qartë se cili është qëllimi dhe çfarë kërkojnë studiuesit. Bazuar në fokusin, metodologjia themelore për

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

analizën duhet të zgjidhet me kujdes (Food Agriculture Organization of the United Nations, 2013).

2.3 Marrëdhëniet brenda zinxhirit të vlerës

Përdorimi i terminologjisë ‘zinxhir’ sugjeron një përqendrim në marrëdhëniet ‘vertikale’ midis blerësve dhe furnitorëve dhe lëvizjen e një malli apo shërbimi nga prodhuesi te konsumatori. Kjo përfshinë një analizë të përqendruar në rrjedhat e burimeve materiale, financave, njohurive dhe informacionit ndërmjet blerësve dhe furnitorëve (Bolwig, S., Ponte, S., Toit, A., Riisgaard, R., Halberg, N., 2008).

Duke marrë parasysh çështjet ekonomike, organizative dhe teknologjike, drejtuesit e performancës së zinxhirit të vlerës janë: mjedisi i përshtatshëm, teknologjia, struktura e tregut, koordinimi, menaxhimi i firmës, inputet (FAO, food and Agriculture Organization, 2007).

Nga hulumtime të bëra viteve të fundit konkludojmë se format më të shpeshta të koordinimit brenda zinxhirit të vlerës janë: koordinimi horizontal dhe koordinimi vertikal. Ndërsa tek sektori i pemëve të imëta nga prodhuesit tonë deri më tani dominon forma e koordinimit vertikal dhe shumë pak ajo e koordinimit horizontal.

Mekanizmi horizontal i koordinimit përbëhet nga kontrata me shkrim, marrëveshje verbale dhe mungesë marrëveshjesh. Për frutat dhe perimet e përpunuara, forma mbizotëruese e transaksioneve është një marrëveshje kontraktuale. Kjo formë e koordinimit vertikal është më e përhapur midis fermerëve dhe akterëve të tjerë në zinxhirin e vlerës. Kontratat e shkruara aktualisht bëhen gjithnjë e më të pranishme, veçanërisht në marrëdhëniet midis shitësve me shumicë dhe përpunuesve. Sidoqoftë, forma e koordinimit përcaktohet gjithashtu nga lloji i produktit, pavarësisht nëse produkti priset shpejtë apo është i qëndrueshëm. Përveç kontratave me shumicë, shitës me pakicë dhe supermarkete, kompanitë përdorin edhe kontrata me fermerët për të adoptuar mekanizma të koordinimit të tregut. Zakonisht takohen fermerët para fillimit të sezonit, ku diskutojnë dhe përcaktojnë çmimin, si dhe cilësinë dhe sasinë e frutave dhe perimeve të kërkuara. Në lidhje me besimin në sistemin gjyqësor për zbatimin e kontratave, rezultatet e

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

anketës tregojnë se ka mungesë besimi në sistem (Miftari, I., 2019).

Ndërsa nga hulumtimi i bërë nga (Miftari, I., 2016), rezultatet e anketës treguan se shumica e të anketuarve nuk janë pjesë e ndonjë grupi prodhuesish bujqësor apo kooperative dhe pjesëmarrja varet nga ekzistenca e këtyre organizatave. Niveli i bashkëpunimit mes fermerëve varej në nivelin e konkurrencës (p.sh. fermerët që prodhojnë mjedra kanë bashkëpunim të mirë me njëritjetrin për shkak se ata nuk përballen me konkurrencë, për dallim nga prodhuesit e perimeve dhe rrushit). Rezultatet e perceptimeve zbuluan se lidhjet personale janë shumë të rëndësishme për shumicën e të anketuarve. Për këtë arsye, një hap i rëndësishëm i ardhshëm është për të analizuar lidhjet personale të fermerëve me akterë të tjerë të zinxhirit të vlerës dhe përtej.

2.4 Rëndësia e studimit të zinxhirit të vlerës

Si në tërësi analizat në zinxhirin global të vlerës (GVC) janë shfaqur që nga fillimi i viteve 1990 si një mjet i ri metodologjik për të kuptuar dinamikën e globalizimit ekonomik dhe tregtinë ndërkombëtare. Ajo bazohet në analizën e zinxhirëve të vlerës diskrete ku furnizimi i inputeve, prodhimi, tregtia dhe konsumi ose asgjësimi lidhen në mënyrë të qartë dhe (të paktën në një farë mase) në mënyrë koherente (Bolwig, S., Ponte, S., Toit, A., Riisgaard, R., Halberg, N., 2008).

Analiza e zinxhirit të vlerës përdoret gjithashtu për qëllime të tjera të ngjashme. Këto përfshijnë promovimin e zhvillimit të ndërmarrjes, rritjen e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit, matjen sasiore të vlerës së shtuar, promovimin e lidhjeve të koordinuara midis prodhuesve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë dhe përmirësimin e pozitës konkurruese të një firme individuale në treg (FAO, food and Agriculture Organization, 2007).

Ekzistojnë tre grupe kryesore të arsyeve pse analiza e zinxhirit të vlerës është e rëndësishme në këtë epokë të globalizimit të shpejtë. Ato janë:

- Me rritjen e ndarjes së punës dhe shpërndarjen globale të prodhimit të përbërësve, konkurrenca sistematike është bërë gjithnjë e më e rëndësishme

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

- Efikasiteti në prodhim është një kusht i domosdoshëm për depërtimin me sukses të tregjeve globale
- Hyrja në tregjet globale që lejon rritje të qëndrueshme të të ardhurave, domethënë bërja më e mirë e globalizimit kërkon një kuptim të faktorëve dinamikë brenda gjithë zinxhirit të vlerës (Kaplinsky, R., Morris, M., 2014).

Analiza e zinxhirit të vlerës gjithashtu është e përshtatshme për të kuptuar se si njerëzit e varfër në zonat rurale të vendeve në zhvillim mund të angazhohen ose të përmirësojnë kushtet e tyre përmes angazhimit me tregtinë e brendshme rajonale ose ndërkombëtare (Mitchell, J., Keane, J., Coles, Ch., 2009).

Analiza e zinxhirit të vlerës përqendrohet në tre çështje kryesore. Së pari, në dinamikën e informacionit në zinxhirin e vlerës nga konsumi përfundimtar deri tek prodhimi primar dhe furnizuesit e inputeve dhe anasjelltas, sa përfshirëse, transparente dhe të përgjegjshme janë informacionet që rrjedhin brenda në zinxhir; deri në çfarë mase tërhiqen vendimet e palëve të interesuara (çfarë të prodhohet, kur prodhohet, si të prodhohet) nga ajo që vlerësojnë konsumatorët? Së dyti, krijimi dhe rrjedha e vlerës në sytë e konsumatorit përfundimtar në secilën fazë të zinxhirit të vlerës, sa nga aktivitetet e prodhimit dhe përpunimit me të vërtetë shtojnë vlerë? Sa investime po bëhen në këto aktivitete kritike? Sa prej tyre janë të nevojshme por nuk shtojnë vlerë (këto duhet të plotësohen me alokimin minimal të burimeve)? Sa janë të panevojshëm (këto duhet të eliminohen dhe burimet të alokohen për krijimin e vlerës dhe efikasitetin e tyre)? Së treti, natyra e marrëdhënieve, sa besim ekziston midis aktorëve të ndryshëm? Cila është natyra e komunikimit brenda dhe midis organizatave? Cila është dëshmia e angazhimit organizativ? Si ndahen rreziqet brenda zinxhirit. Si ndahet vlera e krijuar përgjatë zinxhirit (Soosay, C., Fearne, A., Dent, B., 2012).

Sipas një raporti thuhet se janë disa faktorë të thjeshtë që mund të kenë ndikim tejet të lartë në funksionim të mirë të zinxhirit të vlerës. Megjithatë, pothuajse në tërë Ballkanin Perëndimor gjendja në funksionim të zinxhirit të vlerës qëndron e njëjtë faktorët me ndikim cilësohen të jenë po të njëjt.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Sipas raportit (Lampietti, J., Lugg, D., Van der Celen, P., Branczik, A.), thuhet se ndryshimi i kërkesës së konsumatorit është një nga faktorët kryesorë, një përgjigje ndaj të ardhurave më të larta dhe një preferencë më e madhe për ushqim të sigurt me cilësi të lartë. Kjo ka pasoja të rëndësishme për të gjitha nivelet e zinxhirit ushqimor: fermat, përpunuesit dhe shitësit me pakicë. Ndërsa konsumatorët gjithnjë e më shumë kërkojnë ushqim të sigurt, shitësit me pakicë kërkojnë që furnitorët e tyre të prodhojnë në kushte higjienike, të mbështesin gjurmueshmërinë (aftësia për të gjurmuar historinë e një produkti ushqimor), dhe kërkojnë që produktet të dorëzohen në kohën e duhur dhe në sasi dhe cilësi të mjaftueshme (një parametër që përfshin sigurinë). Liberalizimi i tregtisë do të thotë që produkte me cilësi të lartë dhe me çmim të ulët mund të sigurohen me çmim të ulët nga BE dhe anasjelltas. Kjo u bën presion prodhuesve vendorë për të rritur cilësinë për të konkurruar në treg, duke nxitur ristrukturimin e sektorit dhe duke inkurajuar koordinimin sa më të mirë në zinxhir të vlerës.

Një analizë tipike e zinxhirit të vlerës mund të kryhet në hapat e mëposhtëm:

- Analizat e vet zinxhirit të vlerës - cilat kosto lidhen me secilin aktivitet të veçantë
- Analiza e klientëve të zinxhirëve të vlerës - si përshtatet produkti ynë në zinxhirin e tyre të vlerës
- Identifikimi i avantazheve të mundshme të kostos në krahasim me konkurrentët
- Identifikimi i vlerës së mundshme të shtuar për klientin - si mund të shtojë vlera produkti ynë
- Tek zinxhiri i vlerës së klientëve (p.sh. kosto më të ulëta ose performancë më të lartë) ku i sheh konsumatori potencialet e tilla (Recklies, D., 2001).

Metoda e vlerësimit të shpejtë (Rapid Appraisal Method) është një nga shumë mënyrat që të huajt të mësojnë, në një periudhë të shkurtër të kufizuar për një komunitet ose një zonë apo një aktivitet ose një problem specifik për të cilin mendojnë se nuk dinë sa duhet. Vlerësimi i Shpejtë përshkruan një mënyrë të qasjeve të shpejta për mbledhjen e informacionit dhe jo një metodologji të vetme fikse (Townsend, P., 1993).

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Metoda e vlerësimit të shpejtë është metodë e shpejtë dhe mund të bëhet me kosto relativisht të ulët. Metodatat e vlerësimit të shpejtë mund të ndihmojnë të mblidhni, analizoni dhe raportoni informacionin përkatës për vendimmarrësit brenda ditëve ose javëve (Vondal, P., 2010).

2.5 Sektori i pemëve të imëta në Kosovë

Bujqësia edhe sot vazhdon të jetë ndër sektorët kryesor të shtetit duke dhënë një kontribut të lartë në ekonomi. Sektori i Hortikulturës rezulton të jetë si nënsektori me prioritet të lartë viteve të fundit ku si rrjedhojë e kushteve të përshtatshme dhe fuqisë punëtore është zhvilluar shumë.

Frutat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të zonës së kultivuar bujqësore dhe llogaritet të jetë 23%. Ndër frutat: molla, kumbulla dhe shalqiri, janë ndër më të kultivuarat dhe përfshijnë deri në 5.560 ha. Rritje të ndjeshme është vërejtur gjatë tri viteve të fundit në zonën e kultivuar me shalqinjë. Frutat tjera si: dardha, qershitë dhe pjepëri, janë të kultivuara në zona më të vogla. Dredhëzat dhe manaferrat kanë një pjesë modeste dhe prodhohen në masë të vogël, gjithsesi ato përfaqësojnë një mundësi të rëndësishme në treg dhe vëmendje speciale u është kushtuar atyre nga politikbërësit. Prodhimi mesatar i dredhëzave është më i vogël (3.1 ton/ ha) sesa mesatarja e arritur në vendet rajonale, që është 4 ton/ha (Miftari, I., 2019).

Sa i përket prodhimit të pemëve për vitin 2018, është shënuar rritje për 57% krahasuar me vitin paraprak ku gjithsej sasia e prodhimit për këtë vit është 53,606 tonë. Pothuajse, të gjitha kulturat kanë shënuar rritje të prodhimit krahasuar me vitin paraprak nisur nga ftoi, molla, dardha, arra, lajthia, pjeshka, kumbulla, etj. Ndërsa ulje të lehta nëse krahasohen me vitin 2017, vërehet tek kultura e kajsisë, qershisë, vishnjës dhe dredhëzës (MBPZHR, 2019).

Në vitin 2004, sipërfaqja me dredhëz ishte vetëm 14 ha, kurse në vitin 2019 është zgjeruar në 235 ha. Nëse analizojmë sipërfaqen për periudhën 2015-2019, vërejmë se sipërfaqja e mbjellë ka pasur ndryshime, ku në vitin 2015 ishin 203 ha me dredhëz, pastaj në vitin 2016 dhe 2017 u zvogëlua sipërfaqja në 175 ha, për tu rritur prapë në vitin 2018 dhe 2019 në 235 ha (MBPZHR, 2020).

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Gjatë periudhës 2015-2019, prodhimitaria më e lartë ishte në vitin 2019 ndërsa rendimenti në këtë vit ishte rreth 7 t/ha, i cili pati 27% rritje nga rendimenti i vitit 2018.

Kultura e mjedrës deri në vitin 2018 është subvencionuar në kuadër të subvencionimit të sipërfaqeve të kultivuara me pemishte ekzistuese. Në vitin 2019 për herë të parë ka filluar subvencionimi i prodhimit të mjedrës dhe atë me 0.08 €/kg. Në vitin 2019 sasia më e madhe e mjedrës së subvencionuar ka qenë në regjionin e Prishtinës (57%) e që më së shumti ka pasur nga komuna e Podujevës, pasuar nga regjioni i Ferizajit (28%) ndërsa të gjitha regjionet e tjera kanë pjesëmarrje vetëm 15% (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 2020).




Figura 1: Sipërfaqja e kultivuar me dredhëz 2015-2019

Burimi: Analiza e tregut të dredhëzës, MBPZHR 2020

Prodhimtaria e dredhëzës për vitin 2017 ishte 1,328 tonë, dhe mbulon 84% të nevojave vendore për konsum dhe pjesa tjetër mbulohet nga importi. Për konsum njerëzor janë shfrytëzuar 1,485 tonë, nga totali përdorimit vendor që ishte 1,578 tonë, për procesim janë destinuar 247 tonë, ndërsa si humbje llogariten 93 tonë. Vlera e prodhimitarisë së dredhëzës ishte 0.7 mil. €, që është 11% më e ulët se në vitin 2016, kjo si rezultat i zvogëlimit të sasië prodhuese dhe nëse i referohemi çmimit shohim se nuk ka pasur dallim me vitin 2015, çmimi ka vazhduar të jetë 0.58 € (MBPZHR, 2017).

Nga analiza e tregut të dredhëzës (MBPZHR, 2020) marrë parasysh që Kosova nuk i përmbushë plotësisht nevojat me dredhëz, Kosova vazhdimisht importon nga vendet fqinje si dhe më gjerë. Import të dredhëzës ka më shumë në raste kur në Kosovë nuk është koha adekuate për

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

prodhimtari, ndërsa kur është sezona e prodhimit, Kosova edhe eksporton sasi të mjaftueshme me dredhëz. Bilanci tregtar i dredhëzës ka vazhduar të jetë negativ, gjatë vitit 2016 sasia e dredhëzës së importuar ishte 388 tonë, ndërsa sasia e eksportit ishte 36 tonë (MBPZHR, 2018).

Sasia e dredhëzës së importuar gjatë vitit 2016 ishte 297 tonë, 98% më e lartë se në vitin 2015, ndërsa sasia e eksportit ishte 48 tonë (MBPZHR, 2017).

Sipërfaqja e kultivuar me dredhëz vazhdimisht ka qenë në rritje e sipër, e po ashtu ka pasur rritje të eksportit viteve të fundit. Mirëpo, përkundër zgjerimit të sipërfaqes, për t'i plotësuar nevojat vendore, Kosova vazhdimisht ka importuar dredhëz si produkt i freskët dhe i procesuar. Krijimi i kushteve të avancuara për kultivimin e kulturës së dredhëzës dhe po ashtu rritja e sipërfaqes së mbjellur me dredhëz shihet si një ndër prioritetet për vitet në vijim. Kultivimi i dredhëzës mundëson dhe realizon të ardhura të mira për ekonominë bujqësore, ofron rikthim të shpejtë dhe profitabil të investimit, gjeneron vende të reja të punës si dhe kontribuon në ekonominë e përgjithshme të vendit (MBPZHR, 2020).

Në vitin 2018, të mbjellura me mjedër ishin 1,537 ha, apo shtim i sipërfaqes për 306 ha krahasuar me vitin 2017. Meqenëse, prodhimtaria e mjedrës është sezonale dhe kemi kryesisht afro 4 muaj prodhimtari të mjedrës së freskët, për plotësimin e kërkesave vendore paraqitet nevoja edhe për import edhe pse në sasi të vogël (MBPZHR, 2019).

Vlera e gjithsej importit të dredhëzës në vitin 2019 arriti në 578 mijë €, që ishte vlerë më e madhe krahasuar me dy vitet paraprake. Kur analizojmë importin e vitit 2019 sipas muajve, rrjedhë se vlerë më e madhe e dredhëzës të importuar ishte gjatë muajit Prill (258 mijë €), ndërsa vlerë shumë e vogël paraqitet në muajin Nëntor (5 mijë €) (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 2020).

Duke filluar nga viti 2013, kur ishin mbjellur 23 ha sipërfaqe me mjedër, me prodhimtari prej 105 tonë, trendi i rritjes së sipërfaqes vazhdoi në vitet në vijim. Në vitin 2014 ishin të mbjellura 141 ha, në vitin 2015 ishin 324 ha, duke vijuar me trend të rritjes edhe në vitin 2016, kur kjo sipërfaqe arriti në 797 ha. Rritje më të madhe të sipërfaqes së mbjellur për këtë periudhë kohore

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

kishte në vitin 2018 me 306 ha më shumë, që del të jetë një zgjerim i sipërfaqes së mbjellur me këtë kulturë për 38% për dallim nga viti 2017.




Figura 2: Sipërfaqja e kultivuar me mjedër në ha, 2012-2018

Burimi: Analiza e tregut të mjedrës, MBPZHR 2020

Nga analiza e tregut të mjedrës që është bërë në vitin 2019 rrjedhë se bilanci tregtar i mjedrës gjatë periudhës 2012-2018 ishte pozitiv me rritje të konsiderueshme ndër vite. Në vitin 2018 kishte eksport në vlerë prej 2.3 mil. €, kurse importi arriti vlerën 0.2 mil. €, duke rezultuar me bilanc tregtar pozitiv prej 2.1 mil. € në vitin 2018. Duke filluar nga viti 2012 e deri në vitin 2017 bilanci tregtar i mjedrës kishte trend të vazhdueshëm të rritjes, kur edhe u arrit pika më e lartë e eksportit me bilanc pozitiv prej 2.4 mil. € (MBPZHR, 2019).

Rendimenti i mjedrës në vitin 2013 ishte 4.6 tonë/ha, që vazhdoi me rënie në vitin 2014 në 3.7 tonë/ha. Rendimenti më i lartë u arrit në vitin 2016, me sasi të prodhimit prej 7.8 tonë/ha. Në vitin 2017 kishte rënie të rendimentit (6.3 tonë/ha) dhe kjo rënie vazhdoi edhe në vitin 2018 ku rendimenti për hektar ishte 5.4 tonë (MBPZHR, 2019).

Dredhëza paraqitet me një ngritje të lehtë prej 8.7% të çmimit nga viti 2018 në vitin 2019, ndërsa si rast i veçantë ishte mjedra në Kosovë e rajon në vitet e kaluara që u karakterizua me çmim shumë më të lartë, por që në vitin 2018 çmimi ishte 1.67 €/kg ndërsa në vitin 2019 ishte 1.77 €/kg apo një ngritje për 6.0% (MBPZHR, 2020).

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Prodhimi i mjedrës është i pranishëm për treg nga muaji Qershor deri në muajin Tetor, derisa të paraqiten temperaturat më të ulëta se 2°C. Kultivarët më të përhapur të mjedrës ishin “Polka”, “Willamette” dhe “Miker”. Kultivari “Polka” konsiderohet si një ndër kultivarët më të përhapur në sipërfaqen e përgjithshme të Kosovës që mbjellët me mjedër me pjesëmarrje rreth 80%, i cili njëherësh është edhe kultivari më profitabil dhe më i përshtatshëm për kushtet agroklimate të Kosovës (MBPZHR, 2019).

Plasimi në treg i dredhëzës fillon nga muaji Prill e zgjat deri në muajin Shtator, varësisht prej kushteve klimatike të cilat mundësojnë zhvillimin e kultivimit të kësaj kulture. Nëse analizojmë çmimet e fermës, vërejmë se në vitin 2019 ishte çmimi më i lartë i dredhëzës në vlerë prej 1.12 €, ndërsa ai më u ulëti ishte në vitin 2016, me çmim prej 0.88 €. Sa i përket çmimeve të konsumit, gjatë periudhës 2015-2019 kishte luhatje të këtyre çmimeve. Viti 2017 dhe 2019 shënuan çmimet më të larta për periudhën në fjalë (MBPZHR, 2020).

2.6 Zinxhiri i vlerës në Kosovë dhe te sektori i pemëve të imëta

Hallkat e zinxhirit të vlerës në bujqësi si dhe te nënsektori i pemëve të imëta në Kosovë përbëhet nga fermerët, përpunuesit, tregtarët dhe furnizuesit e inputeve, të cilët njëherësh përfaqësojnë akterët kryesor të zinxhirit të vlerës.

Pavarësisht përfitimeve nga bashkimi i forcave, bashkëpunimi në mes të fermerëve në Kosovë është i dobët. Përvoja ndërkombëtare tregon se fermerët mund të përfitojnë shumë nga bashkëpunimi. Së bashku ata kanë qasje më të lehtë në teknologji, përfitojnë nga avantazhet e shkallës përmes sigurimit ranfuz të inputeve dhe rezultateve, dhe përmirësojnë pozitën negociuese kundrejt furnizuesve të inputeve, tregtarëve, dhe institucioneve financiare. Përpunuesit bujqësorë, tregtarët, dhe bankat preferojnë më shumë të punojnë me grupet e fermerëve sesa me fermerët individual (EFSE, Europe, European fund for southeast Europe).

Në bazë të hulumtimit që është bërë nga (Miftari, I., 2016), konkludojmë se fermerët e mostrës të angazhuar në fruta (pemë të imëta) janë më të arsimuar në krahasim me të tjerët, pemët e imëta janë promovuar shumë së fundmi, si dhe duke pasur parasysh se është më pak tradicional në krahasim me sektorin e vreshtarisë apo perimeve, ndoshta fermerët më të arsimuar dhe më të aftë

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

mund të ketë qenë të interesuar për të hyrë në këtë zhvillim "të ri". Ndërsa industria e përpunimit të frutave dhe perimeve në Kosovë është në rritje dhe teknologjia e saj përpunuese është duke u përmirësuar. Në bazë të kapaciteteve të tyre përpunuese, ka tre kategori përpunuesish:

- Përpunuesit Industrial (Abi & Elif, Euro Food, Koral, Asks-Foods, Moea);
- Përpunuesit mesatar (Bio Pak, Fitimi, Rizona, Etlinger, Ananas Impex, Fungo FF, MIB Trade);
- Përpunuesit e vegjël

Tregtarët (shitësit) në zinxhirin e vlerës së Kosovës për rrush, perime dhe fruta (pemë të imëta) përbëhet nga shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë. Në rastin e produkteve të freskëta për përpunim, është më e zakonshme që fermerët t'i shesin direkt tek përpunuesit, por ato shpesh shiten edhe përmes shitësve me shumicë (Miftari, I., 2016).

Sektori i Hortikulturës është i dominuar kryesisht nga forma e tregtimit në vend (spot market) dhe kontratat joformale në marrëdhëniet midis fermerëve dhe blerësve. Megjithatë, në rastin e marrëdhënieve me përpunues, kontratat formale janë më të zakonshme. Një shumicë e jashtëzakonshme e kultivuesve (në mes 60% dhe 80%) janë në favor të aktiviteteve të përbashkëta (prokurim të përbashkët, përdorimin e makinerive, etj), sidoqoftë ka nivele të kufizuara dhe vetëm disa shembuj të bashkëpunimit në praktikë (Miftari, I., 2016).

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.




Figura 3: Zinxhiri i vlerës tek sektori i pemëve të imëta në Kosovë

Burimi: “Fruits value chain and distribution channels in Kosovo”

Sipas një studimi të bërë tregon se situata në zinxhirin e vlerës tek pemët e imëta është shumë komplekse, aktualisht në këtë zinxhir nevojat e prodhuesve dhe tregtarëve të frutave të freskëta nuk përkojnë mirë me nevojat e përpunuesve të frutave. Industria e përpunimit në Kosovë kërkon sasi të konsiderueshme të frutave të freskëta, të cilat nuk janë gjithmonë të arritshme në tregjet lokale dhe mbulojnë nevojën e tyre nga importet. Në shumë raste, kompanitë vendore të përpunimit përpunojnë frutat që vijnë nga pemishtet e tyre. Një nga arsyet kryesore të një situate të tillë është një mospërputhje midis çmimeve dhe pritjeve të cilësisë midis prodhuesve të frutave dhe përpunuesve të frutave (Gjokaj, E., Halimi, K., Xhabali, V., Imami, D., Gjonbalaj, M., 2017).

Te zinxhiri i vlerës tek ky sektor ende vërehen ngecje të vazhdueshme që shoqërojnë hallkat e zinxhirit të vlerës, të cilat ndikojnë në funksionim jo të mirëfillt dhe jo efikas. Një mos komunikim i rrjedhshëm vërehet qartë që atakon pa ndërprerë këtë pjesë të sektorit.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Ndërsa, sa i përket marrëdhënieve në zinxhirin e vlerës dhe qeverisjes brenda tij nga hulumtimi i bërë me 201 fermerë që kultivojnë dredhëz dhe mjedër thuhet se marrëveshja verbale raportohet të jetë marrëveshja më e zakonshme me 65.5% të rasteve, ndërsa niveli i tregut i rregulluar përmes kontratave me shkrim dhe asnjë marrëveshje nuk raportohet përkatësisht në 17% dhe 17.5% të rasteve. Përveç shkëmbimit të thjeshtë të mallrave, d.m.th. produkte kundrejt parave, që një transaksion të ndodhë dhe të përsëritet në të ardhmen, duhet të sigurohet një vlerësim i cilësisë së produkteve për të shmangur çdo sjellje oportuniste nga shitësi (Gjokaj, E., Halimi, K., Xhabali, V., Imami, D., Gjonbalaj, M., 2017).

Dredhëza dhe mjedra në Kosovë kryesisht kultivohen në parcela shumë të vogëla por në numër të madh të fermerëve. Edhe pse në sipërfaqe modeste të kultivimit prodhuesit e këtyre kulturave kanë arritur të gjejnë një mënyrë të lehtë koordinimi për të arritur qasje sa më të mirë në zinxhir të vlerës.

Rezultatet e suksesshme nga fermat e vogla kanë treguar mundësi për diversifikim me fruta, bimë medicinale dhe aromatike dhe ndërmarrje intensive të Hortikulturës që gjenerojnë kthime tërheqëse. Ky diversifikim është rezultat i një qasje të përqendruar të zinxhirit të vlerës me prodhuesit e vegjël që grumbullojnë produktin e tyre përmes qendrave të grumbullimit të sektorit privat dhe përpunuesve. Edhe pse ende në një nivel modest, suksesi deri më tani tregon potencialin që ekziston për qasjen e përqendruar të zinxhirit të vlerës. Qasja e zinxhirit të vlerës tregon se është thelbësore të vendosen lidhje midis prodhuesit dhe tregut dhe të zbatohen mekanizmat e transferimit të njohurive. Pa të cilën fermerët e vegjël kanë pak mundësi për sukses në treg (Gjokaj, E, Gjonbalaj, M, Halimi, K, Leeds, S., 2018).

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

2.7 Ndikimi i politikave në zinxhirë të vlerës

Përveq koordinimit mes akterëve brenda vlerës zinxhimore për krijimin e një performance sa më të mirë në prodhimin, përpunimin e tregtimin e produkteve bujqësore, rol thelbësor në suksesin e zinxhirit të vlerës luan edhe politika e shtetit.

“Mjedisi i përshtatshëm” përbëhet nga politikat, institucionet dhe shërbimet mbështetëse që formojnë vendosjen e një kornize të përgjithshme sipas së cilës ndërmarrjet krijohen dhe veprojnë. Në varësi të mënyrës se si është e rregulluar, ajo edhe mund ta mbështesë ose të dëmtojë punën e një zinxhiri agroushqimor. Qasja në shërbime, inpute dhe financa konsiderohen të jenë vendimtare për zhvillimin e ZV-së. (Miftari, I., 2016).

Një zinxhir mund të jetë jashtëzakonisht konkurrues ndërkombëtarisht në lidhje me cilësinë dhe kostot e produkteve të tij, por kjo përparësi konkurruese mund të humbet nëse politikat e brendshme kufizojnë aksesin në treg me mekanizma të tillë si taksat e eksportit ose rregulloret e kushtueshme. Nga ana tjetër disavantazhet konkurruese në kosto dhe cilësi mund të kompensohen nga politikat që inkurajojnë investime në teknologjitë e prodhimit ose mbështesin sigurimin e shërbimeve teknike. Të kuptuarit e mjedisit mundësues është thelbësore në analizën zinxhir. Si e tillë, ajo përbën drejtuesin e parë të performancës në kornizë (Food Agriculture Organization of the United Nations, 2013).

Ndryshimet e politikës lokale ndikohen shumë nga situata rajonale. Prodhimi dhe tregtia bujqësore në Ballkanin Perëndimor janë shumë të ndërvarura: zhvillimet e politikës ose të tregut në një vend kanë efektet vijuese mbi vendet e tjera. Shumica e tarifave u shfuqizuan dekada më parë; agrobizneset udhëheqëse të tregut veprojnë në të gjitha vendet dhe kompanitë e shërbimeve (furnizuesit e inputeve dhe konsulencat) janë gjithashtu të pranishme në rajon. Rrjedhimisht, sektori i bujqësisë në Kosovë është shumë i indinjuar nga trendet rajonale: për shembull, zhvillimi i kultivimit të manave në Kosovë rezultoi nga zhvillimi i industrisë në Serbi dhe më pas në Bosnjë dhe Hercegovinë (Gjokaj. E, Gjonbalaj. M, Halimi. K, Leeds. S., 2018).

Në korrik të vitit 2007 Kosova u bë anëtare e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore (CEFTA), e cila bazohet në konceptin e tregtisë së lirë midis vendeve që synojnë të anëtarësohen në BE. Për vite me radhë Kosova është përballur me bilanc negativ të tregtisë

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

agroushqimore. Tregtia është e karakterizuar nga importet dhe nivel shumë i ulët i eksporteve duke rezultuar në një defičit të lartë tregtar, i cili është akoma në rritje. Kontributi i eksporteve agroushqimore në totalin e eksporteve të të mirave ka rënë vazhdimisht gjatë periudhës 2005-2012 dhe arriti 7.5 përqind në vitin 2012. Kontributi i importeve agroushqimore në importet totale të të mirave arriti në 22.8 përqind në vitin 2012, çka është dukshëm më i lartë se kontributi i eksporteve. Tregtia e lirë ka shkaktuar thellim të defičitit tregtar veçanërisht për produktet agroushqimore (Food and Agriculture Organization of the United Nations, 2015).

Deficiti tregtar bujqësor duket të jetë ndihmuar nga liberalizimi i tregtisë. Kosova është palë në CEFTA dhe gjithashtu gëzon status preferencial tregtar me SHBA-në dhe BE-në. Megjithatë, deficiti tregtar në rritje me vendet e CEFTA-s dhe të BE-së vë në pah se marrëveshjet e tregtisë rrisin konsumin e brendshëm të mallrave të importuara, të cilat përfitojnë nga zinxhirët më efikas të furnizimit dhe në disa raste edhe nga subvencionet nga vendet e origjinës. Disa partnerë tregtar të Kosovës subvencionojnë prodhimet bujqësore, veçanërisht në ato shtazore dhe drithërat të cilat qartazi i vënë në disavantazh prodhuesit e Kosovës si në tregjet e brendshme ashtu edhe në ato të eksportit (EFSE, Europe, European fund for southeast Europe).

Marrë parasysh se potenciali i zhvillimit ekonomik të Kosovës në të ardhmen do të duhej të bazohej në tregti, prodhim dhe eksport, CEFTA paraqitet si mjet i rëndësishëm për arritjen e këtyre objektivave. Si pjesë e CEFTA-s Kosova është e hapur për një treg prej afro 20 milion konsumatorëve dhe një BPV (Bruto Produkti Vendor) prej 120 miliard euro, e hapur për shkëmbim të eksperiencës tregtare, teknologjisë, konkurrencës, e njëherazi shërben si parapërgatitje për anëtarësimin në BE dhe Organizatën Botërore të Tregtisë (Instituti për studime të avancuara- GAP, 2011).

Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim Asociim (MSA) me Bashkimin Evropian në vitin 2015. Marrëveshja ka hyrë në fuqi që nga muaji Prill 2016 duke shënuar kështu fillimin e bashkëpunimit kontraktual të Kosovës me BE-në përmes të cilit bashkëpunim Kosova ka nisur rrugën e saj të integritimit evropian (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2017).

Nga kjo marrëveshje të gjitha produktet bujqësore të Kosovës do të eksportohen në shtetet e BE-së me tarifë doganore zero. 256 produkte sensitive bujqësore (180 bujqësore dhe 76 të

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

procesuara bujqësore) të rëndësishme për fermerët e Kosovës do të jenë të mbrojtura dhe tarifa doganore e tyre do të reduktohet gradualisht brenda një periudhe 7 vjeçare (lëngje frutash si lëng molle, luleshtrydhe, kumbulla etj, xhem dhe marmelatë, patate, miell, mish dhe mish i shpezëve, uthull si dhe djathë, etj) (MTI, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, 2017).

Tregu i përbashkët i BE-së mbetet partneri kryesor tregtar i Kosovës. Në 2014, 30% të eksporteve janë plasuar në tregun e BE-së, ndërsa shumica e pjesës së mbetur i përkasin tregut të CEFTA-s (Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë).

KAPITULLI 3: METODOLOGJIA DHE METODAT E HULUMTIMIT

3.1 Metodologjia e aplikuar

Studimi në fjalë në përbërjen e tij është gjysmë sasior dhe gjysmë cilësor. Fillimisht, është bërë analizimi i të dhënave sekondare të cilat ndihmuan në kuptimin e funksionimit të hallkave të zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta. Këto të dhëna siguruan depërtim në zhvillimet e zinxhirit të vlerës dhe për më tepër shërbeu si bazë për përgaditjen e mbledhjes së të dhënave nga terreni. Të dhënat sekondare të përdorura kanë prejardhje nga burime të besueshme, si studime te ndryshme, raporte mbi analizën e tregut të mjedrës dhe dredhëzës nga MBPZHR, raporte të tjera të besueshme, etj. Kjo analizë e të dhënave sekondare njëkohësisht i paraprinë edhe formulimit të pyetësorit. Në anën tjetër të dhënat primare u siguruan nga intervistat e bëra në teren.

Metoda e cila është zgjedhur për këtë studim është “Rapid Appraisal Method” apo “Metoda e Vlerësimit të Shpejtë”. Kësaj metode të realizuar nga FAO i paraprinë pyetësori në të cilën janë identifikuar faktorët të cilët kanë rol kyq dhe që janë përcaktues në funksionimin e zinxhirit të vlerës.

Në këtë hulumtim janë realizuar gjithsej 24 intervista. Këto intervista janë realizuar me profesorë, ekspertë të fushës të cilët punojnë nëpër organizata si USAID dhe GIZ, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, barnatore bujqësore dhe pika grumbulluese. Kështu duke mbërthyer tërë hallkat e zinxhirit të vlerës tek sektori i pemëve të imëta. Për nxjerrjen e rezultateve është përdorur programi microsoft Excel.

Pas realizimit të këtyre 24 pyetësorëve në teren dhe pas marrjes së përgjigjeve nga respondentët e intervistuar kemi bërë vlerësimin e secilit faktorë veçmas. Vlerësimi është bërë me qëllim për të parë performancën e secilit faktorë. Nga vlerësimi i faktorit ne kemi arritur në konkludime nëse faktori përkatës ka dhënë kontribut pozitiv apo ende shfaqen ngecje në zinxhirin e vlerës. Ndërsa, testimi i hipotezave është bërë përmes T-testit, për të parë rëndësinë e variablave në performancën e zinxhirit të vlerës.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

3.1.1. Informata lidhur me pyetësin

“Metoda e Vlerësimit të Shpejtë” e përdorur në këtë studim ndjek strukturën e hapave si në vijim:

1. Identifikimi i faktorëve - Kjo fazë përfshinë identifikimin e faktorëve kyq në performancën e zinxhirit të vlerës. Këta faktorë kryesor pastaj janë ndarë në nënfaktorë efekti i të cilëve ka peshë në funksionimin ndërmjet hallkave të zinxhirit të vlerës. Njohja mirë e këtyre parametrave është thelbësore për vlerësimin e efektit të tyre brenda për brenda strukturës së zinxhirit.
2. Përcaktueshmëria e kontrollimit të faktorëve – Pas identifikimit dhe njohjes së faktorëve, duhet përcaktohet se nga kush janë të kontrolluar këta faktorë dhe nënfaktorë. Vlerësimi do të bëhet ndërmjet opsioneve si : a) faktorë të kontrolluar nga firma (FKF), b) faktorë të kontrolluar nga qeveria (FKQ), c) faktorë pjesërisht të kontrolluar (FPK), d) faktorë të pakontrolluar (FP).
3. Vlerësimi i peshës dhe rëndësisë së secilit faktorë (Relevanca dhe pesha)
Relevanca – Shpreh kontributin e një nënfaktori të caktuar, qoftë ai pozitiv apo negativ në performancën e zinxhirit të vlerës. Tek relevanca vlerësimi përfshinë një interval ku alternativa “shumë i favorshëm” paraqet vlerën e skajshme pozitive të kontributit të nënfaktorit ndërsa “shumë i pafavorshëm” vlerën e skajshme negative të kontributit të faktorit.
Pesha - këtu nënfaktorët do të peshohen për të parë aftësinë e ndikimit të tyre në performancën e faktorit kryesor. Intervali i vlerësimit tek pesha do të sillet nga 0 – 1.
Me shumëzimin e “relevancës” dhe “ peshës” ne fitojmë një vlerësim të përgjithshëm të ndikimit të këtyre faktorëve në performancën e zinxhirit.

Faktorët janë analizuar për të parë kontributin dhe peshën e tyre në performancën e zinxhirit të vlerës tek mjedra dhe dredhëza. Pyetësi përfshinë të gjitha hallkat e zinxhirit të vlerës, prej prodhimit deri tek shitja. Më poshtë është paraqitur në mënyrë grafike skema e faktorëve të studiuar.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.



Figura 1: Faktorët e përfshirë në pyetësor

KAPITULLI 4: REZULTATE DHE DISKUTIME

4.1 Vlerësimi dhe kontrollueshmëria e faktorit

Në pjesën e kapitullit të rezultateve do të diskutohen rezultatet që kemi arritur të nxjerrim nga puna në teren. Do të bëjmë vlerësimin e faktorëve dhe nënfaktorëve. Vlerësimi i faktorit arrihet kur shumëzohet relevanca me peshën. Sa më e lartë vlera aq i lartë është edhe kontributi i faktorit dhe anasjelltas, vlera sa më e ulët tregon se faktori nuk ka dhënë kontribut në zinxhirin e vlerës. Faktorët të cilët janë të shprehur me vlera negative tregon se ka ngecje dhe se nevoja për intervenim është më se e nevojshme.

Gjithashtu, në këtë kapitull do të shohim kontrollueshmërinë e faktorëve, se a janë të kontrolluar nga firma, qeveria, pjesërisht të kontrolluar apo faktorë të pakontrolluar. Dhe, në rastet kur kemi ngecje, si mund të ndikohet në përmirësimin e gjendjes.

4.1.1 Tregu ndërkombëtar




Figura 1: Vlerësimi i faktorit "Tregu ndërkombëtar"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Në grafikun e mësipërm kemi bërë vlerësimin e faktorit "Tregu ndërkombëtar". Nga ky vlerësim i bërë nga përgjigjet e respondentëve ne arrijmë të identifikojmë kontributin dhe peshën e nënfaktorëve në veçanti si dhe faktorit në përgjithësi. Dhe, mund të themi se nga nënfaktorët e

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

përfshirë (MSA, CEFTA, Barrierat jo-tarifore, Barrierat tarifore, Tregjet me vendet e tjera) dhanë kontribut pozitiv përveq barrierave tarifore.

Kontributi i MSA-së dhe barrierave jo-tarifore shihet të jetë minimal. Ndërsa sa i përket tregjeve me vendet e tjera Kosova qëndron mjaft mirë. Kur flasim për mjedrën, prodhimi i së cilës 90% destinohet për eksport sot ka arritur tu bëjë konkurrencë shumë vende Evropiane që kanë traditë në kultivimin e mjedrës. Ndërsa dredhëza është e destinuar kryesisht për tregun vendor dhe shumë pak eksportohet.

Sa i përket tregut ndërkombëtar Kosova qëndron ende larg sa i përket fushës së bashkëpunimit dhe përshtatjes së kushteve dhe rregullave të marrëveshjeve të ndryshme Evropiane. Edhe pse është bërë pjesë e MSA-së dhe CEFTA-së tasht e sa vite Kosova ende nuk ka arritur të shoh efektin e plotë të këtyre antarësimeve në zinxhirin e vlerës tek kultura e mjedrës dhe dredhëzës.

Nga të gjithë të intervistuarit u pa qartë se shumica prej tyre nuk kanë arritur të shohin ndonjë efekt të theksuar pozitiv të disa faktorëve. Disa prej tyre u shprehen se Kosova si para antarësimit si pas antarësimit vazhdon të funksionoj njëjtë sa i përket zinxhirit të vlerës.

Nga intervistat e realizuara në teren rreth funksionimit të zinxhirit të vlerës tek mjedra dhe dredhëza respondentët u shprehen se përfitimet nga këto marrëveshje janë shumë të mëdha sikurse Kosova të arrinte të i shfrytëzonte mirë. Dhe, një nga shkaqet për këtë mos shfrytëzim sipas tyre është që ne ende nuk i plotësojmë kriteret e parapara në këto marrëveshje sidomos atë të MSA-së.

Ata të cilët kanë arritur të shfrytëzojnë përfitimet nga këto faktorë të tregut ndërkombëtar kanë arritur të marrin një kontribut të lartë. Meqenëse CEFTA ka aftësi të lartë të kontributit lidhur me eksportin dhe importin ajo mund të jetë një mundësi e mirë për negociim në të ardhmen.

Barrierat tarifore ndikuan negativisht tek zinxhiri i vlerës së pemëve të imëta, ku në ato periudha kur u vendos tarifë ndikoi drejtpërsëdrejti në ulje të performancës.

Faktorët e tregut ndërkombëtar kontrollohen kryesisht nga qeveria. Aplikimi dhe implementimi i MSA-së në Kosovë sipas përgjigjeve të respondentëve varet nga fakti se sa qeveria është e gatshme që të aplikoj masat nga kjo organizatë. Nga 24 respondentë sa ishin gjithsej, 16 prej tyre

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.

apo rreth 66% e tyre u shprehen se implementimi i CEFTA-së në Kosovë varet nga vendimet e qeverisë.

Ndërsa me faktorin tregjet me vendet e tjera, ku përfshihet tregtia e kulturës së mjedrës dhe dredhëzës me vendet jo fqinje por më gjerë, puna qëndron ndryshe. Përveq qeverisë rol në kontrollueshmërinë e këtij faktori luan edhe ferma. Kjo lidhet me faktin që në Kosovë kemi ekonomi të lirë, dhe se vet fermeri mund të zgjedhë tregjet apo vendet se ku dëshiron të eksportojë prodhimin e tij.

4.1.2 Kultura

Faktorët si cilësia e tokës, analizat e tokës, klima dhe madhësia e fermës luajnë rol kyq dhe determinues në funksionim sa më efikas të zinxhirit të vlerës. Efekti i këtyre faktorëve ndikon shumë tek cilësia e mjedrës dhe dredhëzës. Prandaj, këtyre faktorëve u ëshë kushtuar vëmendje shumë e madhe gjatë hulumtimeve të bëra në teren.




Figura 2: Vlerësimi i faktorit “Kultura”

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Nga përgjigjet e marra të respondentëve arrijmë në konkludim se tek sektori i pemëve të imëta këta faktorë qëndrojnë në numra pozitiv. Se cilësia e tokës dhe klima i përshtatet kulturës së mjedrës dhe dredhëzës e dëshmon edhe grafikoni i mësipërm.

Shumica e respondentëve u shprehen se cilësia e tokës është faktorë tejet i rëndësishëm. Toka e Kosovës si resurs është tejet e përshtatshme për kultivimin e pemëve të imëta. Në rajonet ku kultivohen në sasi të mëdha mjedra e dredhëza, toka del të jetë e favorshme, duke dhënë një prodhim të lartë për ha. Fermerët vet zgjedhin vendin se ku dëshirojnë të prodhojnë. Për të cilën ekspertët mendojnë se deri sot ata kanë arrit të bëjnë zgjedhjen e duhur, kështu duke zgjedhur tokën më të përshtatshme për kultivim.

Cka vlen të diskutohet është se pavarësisht që si faktorë analizat e tokës del të jetë pozitiv, ende sot një numër i konsiderueshëm i fermerëve nuk kryejnë analiza të tokës. Madje, disa prej tyre gjatë intervistimit thanë se analiza të tokës kryejnë vetëm fermerët prodhimi i të cilëve destinohet për eksport. Ata të cilët shesin brenda vendit, analizat e tokës nuk luajnë ndojnë rol të rëndësishëm. Dhe krejt kjo, mendohet të jetë nga fakti që shtetet Evropiane kanë të përpiluara kushtet të cilat prodhimi i një kulture duhet t'i përshtatet.

Faktorë tjetër që ndikon në mos kryerje të analizave të tokës është fakti së prodhuesit janë shtresa me nivel të ulët të arsimit. Këta prodhues nuk kanë njohuri të mira për analizën e tokës kështu duke bërë që ata të mos i japin vëmendje kësaj fushe.

Klima e Kosovës e favorizon shumë kultivimin e mjedrës dhe dredhëzës. Pavarësisht rasteve të rralla ku këto kultura kanë pësuar dëme nga kushtet atmosferike, të gjithë të intervistuarit u shprehen se klima i përshtatet këtyre kulturave.

Problemi më i madh në bujqësinë e Kosovës sot është aspekti i madhësisë së fermës. Vetëm një pjesë tejet e vogël e fermave i takojnë grupit të fermave të mesme apo të mëdha. Ndikim të madh këtu ka parcelizimi i tokës në shumë pjesë si pasojë e formës së trashëgimit të pasurisë në vendin tonë. Edhe pse qeveria ka bërë përpjekje përmes disa formave stimuluese të rris madhësinë e fermës ende ky aspekt mbetet për tu dëshiruar. Në kuadër të grandeve sot Ministria i përkrah më

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

tepër fermerët të cilët kanë ferma të mëdha. Kurse tek subvencionet në bazë të sasisë së prodhimit për ha.

Rritja e madhësisë së fermës ndikon në rritje të produktivitetit e efijencës si dhe ulje të përgjithshme të kostove.

Nga puna në teren vlerësojmë se sa i përket kontrollueshmërisë, cilësia e tokës është një faktorë që kontrollohet kryesisht nga ferma. Nga 24 respondentë, 11 prej tyre treguan se është në dorën e vet fermerëve të përcaktojnë vendin e kultivimit të mjedrës dhe dredhëzës duke përshtatur cilësinë gjithashtu.

Tjetër faktorë tejet i rëndësishëm dhe determinues në performancës e zinxhirit të vlerës janë analizat e tokës. Ashtu si edhe cilësia e tokës edhe analiza e tokës si faktorë kontrollohet kryesisht nga vet fermeri dhe në raste të vogla nga Qeveria ose nga kto të dyja njëkohësisht. Qeveria aktualisht është duke tentuar që përmes politikave bujqësore të rris vetdijesimin për rëndësinë e analizave të tokës.

Klima si faktorë del të jetë kryesisht i pakontrolluar. Nga 24 intervista sa ishin gjithsej 18 prej tyre treguan se klimën si faktorë nuk mund ta kontrollojmë dhe se Bujqësia vazhdimisht i kanoset rreziqeve të motit. Gjithashtu, një respondentë deklaroi se klima nuk mund të kontrollohet përveq rasteve kur prodhimi gjendet në serrë. Në këto raste fermeri ka mundësi të diktojë klimën duke e përshtatur me prodhimin.

4.1.3 Pajisjet

Nga hulumtimi i realizuar në teren është bërë një analizim edhe rreth teknologjisë në zinxhirin e vlerës tek sektori i pemëve të imëta. Si një indikator kyq që ndikon direkt në prodhim, përpunim, tregtim e shitje, ka qenë e rëndësishme të shihet se si qëndron puna e ZV-së tek mjedra dhe

dredhëza në këtë aspekt.




Figura 3: Vlerësimi i faktorit "Pajisjet"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Nga të gjithë intervistat e realizuara me respondentët mund të themi se 90% e tyre u shprehën se teknologjia ka rol tejet të madh tek përpunuesit. Kurse tek prodhuesit roli i saj nuk vihet shumë në theks.

Sa i përket adaptimit me teknologji, ZV-së te sektori i pemëve të imëta qëndron mirë. Përpunuesit kanë arritur mjaft mirë të përshtatin teknologjinë. Krejt kjo ka ardhur nga ajo se përpunimi përbën një proces mjaft delikat në vetvete, ku nga gabime tejet të vogla mund të shkaktohen humbje të cilësisë. Ndërsa tek prodhuesit primar ende vërehet teknologji e vjetërsuar si dhe ritëm tejet i ngadalshëm i adaptimit me teknologjinë e re.

Asistenca teknike apo ekspertiza nuk shihet të jetë problem në vlerën zinxhirore tek mjedra dhe dredhëza. Ky faktorë dha kontribut pozitiv në të gjitha hallkat e zinxhirit. Asistenca teknike në Kosovë tek ky sektor ofrohet nga organizata të ndryshme, shoqata dhe donator. Në disa raste asistenca teknike ofrohet edhe nga shitësit e teknologjive, ku ju jepen udhëzimet e nevojshme përpunuesve, procesuesve rreth përdorimit të pajisjeve. Nuk ka mungesë të asistencës teknike mirëpo fermerët po ngurrojnë të paguajnë për të.

4.1.4 Inputet




Figura 4: Vlerësimi i faktorit "Inputet"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Kualiteti n'varet nga kontrolla e inputeve që bëhet kur ato hyjnë në tregun vendor. Kontrollimi i fidaneve, plehut si dhe produkteve të mbrojtjes së bimëve (kimikateve), janë tejet të rëndësishme për determinim sa më të mirë të cilësisë.

Ngecje në zinxhirin e vlerës tek mjedra dhe dredhëza sa i përket këtyre inputeve nuk vërehen. Efekti i tyre vlerësohet të jetë pozitiv mirëpo në nivelin e tij minimal. Ky efekt minimal tregon se nevojat për përmirësim janë ende të larta në këtë mënyrë për të ndihmuar që vlera zinxhimore të këto kultura të jetë sa më efiçente.

Të gjitha inputet në Kosovë janë të importuara nga vende të ndryshme fqinje dhe jo-fqinje. Respondentët u shprehen se fidanet e mjedrës dhe dredhëzës janë të përshtatshme por jo në nivelin e duhur. Vazhdimisht këto fidane ju kanosen rreziqeve të sëmundjeve të ndryshme si dhe rreziqeve të mos përshtatjes. Madje, tek mjedra ka pas raste kur fidanet janë importuar të sëmura duke shkaktura probleme të mëdha tek fermerët në vend.

Plehu dhe produktet e mbrojtjes së bimëve në vendin tonë gjenden në sasi dhe lloje të mjaftueshme. Fermerët që prodhojnë mjedër dhe dredhëz nuk ndeshin probleme lidhur me mungesën e këtyre inputeve. Plehu dhe produktet e mbrojtjes së bimëve ju përshtaten kultivarëve

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

të mjedrës dhe dredhëzës. Disa respondentë u shprehën se nëse këto inpute përdoren sipas udhëzimeve, në sasi dhe kohën e duhur japin rezultate shumë të mira.

Inputet e tjera si karburantet, uji dhe energjia elektrike vazhdojnë edhe sot të shkaktojnë probleme herë pas here tek fermerët. Për fermerët karburantet cilësohen të jenë në cmime të larta. Ndërsa mungesa herë pas here e energjisë elektrike po ndikon në ulje të cilësisë së mjedrës dhe dredhëzës. Po ashtu, energjia elektrike konsiderohet të ketë një tarifë të lartë. Fermerët dhe pikat grumbulluese të cilët kanë friza për ngrirje janë ata që po ballafaqohen më së shumti me këtë problem. Mungesa e energjisë elektrike me nga 2-3 orë po bën që cilësia e mjedrës dhe dredhëzës të bie. Dhe në këto raste po kërkohet të bëhet një intervenim i shpejtë në mënyrë që cilësia e prodhimit të mos bie edhe më shumë.

Që nga momenti i prodhimit e deri të konsumi, fermerët kanë nevojë për këshilla për arritjen e praktikave më të mira. Aplikimi i vazhdueshëm i shërbimeve këshillimore tek fermerët ndikoi në ngritje të performancës së zinxhirit të vlerës, duke bërë atë të funksionoj lehtë dhe eficientë. Në Kosovë, vazhdimisht bëhet ofrimi i shërbimeve këshillimore për fermerë. Janë dy forma të ofrimit të këshillave, privat dhe publik. Nga këto forma të këshillimit, ai privat ka dhënë efekt më të lartë në zinxhirin e vlerës tek mjedra dhe dredhëza. Këshillimi privat jepet nga donator të ndryshëm dhe organizata jo-qeveritare qëllimi i të cilëve është të jenë sa më pranë fermerëve për aplikimin e praktikave më të mira të prodhimit. Ndërsa ai publik jepet nga Ministria përkatëse.

Vitet e fundit angazhimi i donatorëve dhe organizatave jo-qeveritare ka pas një rol kyq në përmirësimin e zinxhirit të vlerës. Përmes trajnimeve, konferencave, kampanjave dhe broshurave të ndryshme kanë arrit të përmirësojnë hallkat e zinxhirit të vlerës. Angazhim tejet i madh është bërë tek kultura e mjedrës në pesë vitet e fundit, pasi që kjo kulturë në këto vite mori hov të madh të kultivimit. Por, edhe sot ende fermerët ngurrojnë të paguajnë për shërbime këshilluese private.

Ofrimi i këshillimit publik është bërë përmes angazhimit të këshilltarëve në nivel lokal. Është bërë angazhim i vazhdueshëm por jo në nivel të kënaqshëm. Duhet të theksohet se përfshirja e ulët e drejtorive bujqësore në këshillimin e fermerëve për çështje të ndryshme është raportuar

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.

gjatë hulumtimit. Sipas disa respondentëve thuhet se ky lloj këshillimi ofrohet vetëm për një pjesë të fermerëve dhe se nuk ka kapacitet të ofrojë këshilla për të gjithë fermerët.

Ndërsa sa i përket kontrollave kufitare nga sistemi fitosanitar puna qëndron jo mirë. Nga puna në teren e bërë u pa qartë se Kosova vuan për kontrollën e inputeve.

4.1.5 Fuqia punëtore

Nga tre nënfaktorët e përfshirë në kuadër të fuqisë punëtore, konkludojmë se përvoja ishte nënfaktori më influencues tek zinxhiri i vlerës tek mjedra dhe dredhëza. Përvoja është vlerësuar me vlerën më të lartë 0.28, ndërsa kualifikimi dhe trajnimet me vlerë të njëjtë, 0.15. Punëtorët në procesin e prodhimit dhe përpunimit shihen të jenë me nivel të ulët të arsimimit prandaj kualifikimi jep një kontribut pozitiv minimal. Në shumicën e rasteve kualifikimi i fuqisë punëtore nuk konsiston adekuat me punën që ata kryejnë.




Figura 5: Vlerësimi i faktorit "Fuqia punëtore"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

4.1.6 Struktura e tregut




Figura 6: Vlerësimi i faktorit " Struktura e tregut"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Efekti i faktorëve si tregu vendor, tregu rajonal, kontratat/kushtet e pagesës dhe komercializimi/shitja në vlerën zinxhirore tek mjedra dhe dredhëza dhanë efekt pozitiv. Siç shihet edhe nga grafikoni, tregu vendor në zinxhirin e vlerës tek mjedra ka dhënë efekt pozitiv minimal. Ndërsa tek dredhëza ka dhënë efekt më të lartë.

Meqenëse mjedra eksportohet dhe një sasi e vogël shitet në vend, e shpjegon edhe arsyen pse respondentët u përgjigjën se tregu vendor luajti pak rol në vlerën zinxhirore. Në rastet kur kjo kulturë shitet në vend, tregu vendor mund të themi se ofron mundësi të mira për shitje, duke mos shkaktuar teprica të prodhimit. Për këtë arsye tek kjo kulturë rol të rëndësishëm pati tregu rajonal, i cili ofroi mundësi të mëdha për shitje. Kurse dredhëza e cila shumica konsumohet në vend dhe një sasi tejet e vogël eksportohet roli i tregut vendor ishte më i theksuar.

Dredhëza e Kosovës ofrohet në treg nga muaji Maj deri në muajin Shtator, duke mbuluar afro 69% të nevojave. Ndërsa pjesa tjetër importohet nga vende të ndryshme. Gjatë periudhës kur kjo kulturë ofrohet në treg nga fermerë vendor, tregu ofron mundësi të mira për plasim dhe shitje me çmime të favorshme.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.

Mjedra gjatë viteve të fundit ka rritur sipërfaqet e kultivimit ndjeshëm kështu duke arritur të eksportohet në vendet si: Gjermani, Hungari, Serbi, Zvicërr, etj.

Tek sektori i pemëve të imëta forma më e shpeshtë e kontraktimit të prodhimit është me anë të kontratave. Gjatë intervistave që kam bërë me ekspertë të pikave grumbulluese ata u shprehën se në shumicën e rasteve lidhin kontrata me fermerët duke paracaktuar çmimin për kilogramë të prodhimit. Me aplikim më të madh të kontratave është lehtësuar edhe shitja e prodhimit. Vërehet qartë një rritje e vetëdijësisë të fermerëve në aspektin e shitjes. Kur ata fillojnë të planifikojmë fillimisht po orientohen tek blerësi, tek ajo se si dhe ku do të shitet prodhimi. Për cka e ka lehtësuar shumë aspektin e shitjes

4.1.7 Menaxhimi në fermë

Nga faktori i menaxhimit në fermë u përfshinë nënfaktorët si: planifikimi i prodhimit, menaxhimi i cilësisë, kontabiliteti në fermë, burimet e financimit të investimeve, bashkëpunimi mes akterëve të ZV-së dhe vendimmarrja. Nga këta nënfaktor të gjithë dhanë kontribut pozitiv përveq planifikimit të prodhimit dhe kontabilitetit në fermë. Faktorët e tjerë kontributin e tyre e shprehën në terma pozitiv në lartësi të ndryshme, disa me peshë më të lartë e disa më peshë më të ulët. Prej tyre bashkëpunimi mes akterëve dha kontributin më të lartë me vlerë 0.13 sipas vlerësimit të faktorit. Në grafikonin e mëposhtëm janë paraqitur në mënyrë grafike efekti i secilit faktorë në zinxhirin e vlerës tek kultura e mjedrës dhe dredhëzës.




Figura 7: Vlerësimi i faktorit " Menaxhimi në fermë"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Fermerët që kultivojnë mjedër dhe dredhëz nuk planifikojnë, për cka e dëshmon edhe grafikoni. Ata direkt vazhdojnë prodhimin pa bërë një planifikim se si, ku dhe cfarë do të prodhojnë. Kjo ndryshon në rastet kur fermerët janë përfitues të grandeve, sepse Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i obligon fermerët që të bëjnë planifikim të prodhimin nëse dëshirojnë të jenë përfitues të grandeve qeveritare.

Menaxhimi i cilësisë edhe pse me kontribut pozitiv, vazhdon të shihet si një faktorë relevant, ku vazhdimisht ndryshon cilësia. Në rastet kur mjedra eksportohet cilësia vazhdimisht shkon duke u përmisuar. Ndërsa kur mjedra dhe dredhëza destinohet për treg të brendshëm atëherë kemi luhatje të cilësisë. Sipas përgjigjeve të respondentëve kjo vjen si pasojë e mos kontrollimit të vazhdueshëm në menaxhimin e cilësisë nga ana e vet fermerëve si dhe angazhimi tejet i ulët i inspektoriatit.

Numër i vogël i fermerëve mbajnë shënime të kontabilitetit. Nga ky numër një pjesë e vogël mbajnë shënime të plota të kontabilitetit kurse pjesa tjetër mbajnë shënime të thjeshta. Fermerët të cilët mbajnë shënime të thjeshta, kalkulojnë vetëm shpenzimet kryesore dhe të hyrat kur ata shesin prodhimin e tyre. Shpenzimet e tjera të kostove dhe të hyrave ata nuk i marrin parasysh gjatë prodhimit. Një arsye për këtë ngecje sipas respondentëve mendohet të jetë niveli i ulët i arsimimit si dhe vështirësitë në kuptimin se si duhet të mbahen shënimet në fermë.

Sipas komenteve të disa respondentëve përpunuesit dhe tregtarët pjesërisht mbajnë kontabilitet. Për rrjetet tregtare nga ferma kontrollohet totalisht kontabiliteti.

Mosmbajtja e shënimeve në fermë dhe moskalkulimi i të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve ka bërë që fermerët që kultivojnë mjedër dhe dredhëz herë pas here të dalin në humbje. E kjo ka bërë që fermerët të mos arrijnë të identifikojnë pikat ku ata duhet të përmirësohen, kështu duke vazhduar me vite të prodhojnë me humbje.

Sot qeveria është shumë e angazhuar në fushën e mbajtjes së shënimeve në fermë. Përmes një rrjeti të krijuar, FADN (Analiza e të dhënave të rrejtit të kontabilitetit në fermë) bën përpjekje për futjen e mbajtjes së shënimeve në fermë të një numri sa më të madh të fermerëve. Aktualisht ky rrjet ka një mostër prej 1250 fermave për vitin 2019.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Bashkëpunimi mes akterëve të zinxhirit të vlerës te pemët e imëta është shumë i mirë, sidomos tek mjedra. Bashkëpunim i mirë mes akterëve funksionon si tek mjedra e freskët ashtu edhe tek ajo e ngrirë. Fermerët nuk po hasin në probleme që të gjejnë pika grumbulluese për të shitur prodhimin e tyre.

Sa i përket vendimmarrjes respondentët treguan se vendimmarrja është përmirësuar por ende ndodh që fermerët të marrin vendime të ngutshme.

4.1.8 Makroekonomia




Figura 8: Vlerësimi i faktorit "Makroekonomia"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Fermerët e Kosovës vazhdimisht janë të lidhur me sistemin bankar shkaku i mundësive të ulëta për vetfinansim. Marrja e kredive është më se e zakonshme tek fermerët por edhe tek përpunuesit. Ata zakonisht ju drejtohen bankave për fillimin e një biznesi, përveq rasteve kur atyre u ndihmojnë organizatat ose donatorët.

Kushtet për përfitimin e një kredie në Kosovë nga përgjigjet e respondentëve del të jenë vështirë të plotësueshme nga fermerët. Prandaj ky faktorë pas analizimit të të dhënave shihet se dha një kontribut tejet të ulët pozitiv. Rreth 45% e të intervistuarve u përgjigjen se nuk është e lehtë të

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

marrësh një kredi në vendin tonë. Normat e interesit konsiderohen ende të larta edhe pse krahasuar me periudhën e pas luftës janë ulur ndjeshëm. Madje, krahasuar me rajonin mund të themi se normat e interesit në Kosovë janë më të lartat. Në anën tjetër periudhat e pushimit shihen si të shkurtëra.

Të ardhurat e sektorit sipas hulumtimit në teren konsiderohen të jenë të favorshme. Niveli i knaqshëm i të ardhurave ndikoi në rritje të rendimentit por edhe të sipërfaqeve të kultivuara me mjedër dhe dredhëz. Nga viti në vit kemi pasur shtim të vazhdueshëm të sipërfaqeve dhe rritje të numrit të fermerëve që kultivojnë këto kultura

Me rritjen e sipërfaqeve është rritur edhe konkurenca. Tek kultura e mjedrës në pesë vitet të fundit është parë një konkurrencë e madhe. Si pasojë e kultivimit të madh të mjedrës cmimi i saj është ulur, duke dekurajuar fermerët të mbjellin atë. Sot ky problem është eliminuar, konkurenca vazhdon të jetë e favorshme pasi që ndikoi në përmirësimin e cilësisë së mjedrës. E njëjta gjendje vazhdon të jetë edhe tek dredhëza e cila kultivohet në Kosovë në sipërfaqe më të ulët se mjedra. Në vitin 2018 me dredhëz u mbollën 245 ha ndërsa me mjedër 1537 ha.

Madhësia e tregut rezulton të jetë një faktorë me efekte pozitive sipas ekspertëve. Kurse madhësia e importit tejet negative. Në vendin tonë ende sasi e madhe e këtyre kulturave importohen. Ky import është më i theksuar jashtë sezonave kur nuk kemi prodhim vendor. Bilanci tregtar për kulturën e mjedrës rezulton të jetë pozitiv gjatë periudhës 2012-2017 duke arritur eksportin më të lartë në vlerë 2.4 milion euro. Dredhëza e freskët rezulton negativ në bilancin tregtar, kurse ajo e procesuar me bilanc pozitiv sidomos gjatë vitit 2018 dhe 2019.

Kosova në hartën botërore të prodhimit të mjedrës për vitin 2019 ka zënë vendin e 18-të.

Meqenëse flasim për kultura të cilat eksportohen dhe që kanë bilanc tregtar pozitiv tregon rëndësinë e lidhjeve tregtare tek këto kultura. Kapaciteti i eksportit të mjedra dhe dredhëza qëndron mirë por ende jo në sasi të larta. Pikat grumbulluese gjatë intervistimit u shprehën që kërkesat për eksport janë tepër të larta. Ata e kanë të vështirë t'i përmbushin këto kërkesa, prandaj po stimulohen fermerët që të vazhdojnë të rrisin parcelat e kultivuara me mjedër dhe dredhëz.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Politikat bujqësore në krahasim me sektorët e tjerë janë më të favorshmet. Kultura e mjedrës deri në vitin 2018 është subvencionuar në kuadër të subvencionimit të sipërfaqeve të kultivuara me pemishte ekzistuese. Mirëpo nga viti 2018 ka ndryshuar skema duke kaluar nga subencionimi për sipërfaqe në subvencionim për kg. Ky subvencionim paguhet me një shumë prej 0.08€/kg.

4.1.9 Rregullativat e sigurisë ushqimore

Rregullativat e sigurisë ushqimore përbëjnë faktorin kyq në zinxhirin e vlerës, pa të cilat nuk mund të imagjinohet tregtia e ushqimit. Standardet e ushqimit ndihmojnë në krijimin e besimit të konsumatorit më vërtetësinë e asaj që konsumojnë. Rregullativat e sigurisë ushqimore kanë qëllimin e ofrimit të një ushqimi të shëndetshëm, sigurtë dhe cilësor.

Në pyetësor unë kam përfshirë rregullativat si HACCP, ISO, GLOBAL GAP dhe BIO (Organike). Të cilat rezultuan si faktorë me ndikim duke dhënë kontribut të favorshëm. Se janë tejet të rëndësishme të aplikohen e dëshmuar përgjigjet e respondentëve ku të gjithë u shprehen se janë thelbësore për një ushqim sa më të sigurt.




Figura 9: Vlerësimi i faktorit " Rregullativat e sigurisë ushqimore"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Grafikoni tregon se rregullativat janë duke u aplikuar tek zinxhiri i vlerës së mjedrës dhe dredhëzës nga procesi i përpunimit e tutje. Aplikim i vazhdueshëm bëhet sidomos nga pikat grumbulluese kur 96% të prodhimit e shesin jashtë vendit dhe vetëm 4% për konsum të

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

brendshëm. Fermerët nuk kryejnë monitorime të rregullta të kontrollit të tokës dhe ujit për ujitje. Kontrollat janë të aplikuara vetëm në rastet kur eksportohet.

4.1.10 Inspektimi




Figura 10: Vlerësimi i faktorit "Inspektimi"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Sipas respondentëve Kosova ka krijuar një sistem të shërbimit të inspektimit mjaft të mirë. Aktualisht janë një numër i madh i inspektorëve sanitar/ fitosanitar të angazhuar në vendin tonë. Puna e tyre sipas hulumtimit në teren del të jetë jo në nivelin e pritshëm. Kontrollat në teren nga inspektorët janë të rralla dhe sipërfaqësore. Gjatë intervistimit me pikat grumbulluese treguan se nuk bëhet inspektim në kompanitë e tyre. Prandaj, në këtë pikë mbetet ende shumë për tu punuar në mënyrë që të arrihen qëllimet e përcaktuara nga Agjensia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

4.1.11 Koordinimi i zinxhirit




Figura 11: Vlerësimi i faktorit “Koordinimi i zinxhirit”

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Të dy format e koordinimit të zinxhirit të vlerës si koordinimi vertikal edhe ai horizontal janë të shprehura në sektorin e pemëve të imëta. Shumica e repondentëve u përgjigjen se kontratat me shkrim po aplikohen në shumicën e rasteve. Ku nëse bëjmë krahasim me raporte të bëra në vitin 2016, ku thuhet se kontratat aplikohen shumë pak, vërejmë një përmirësim të gjendjes. Kjo formë e kontraktimit është e aplikueshme sidomos mes fermerëve dhe pikave grumbulluese. Por, ende në disa raste të rralla vazhdon shitja me para në dorë, kjo më shumë është e shprehur tek furnizuesit e inputeve.

Te zinxhiri i vlerës tek mjedra shihet një përmirësim i bashkëpunimit mes akterëve të zinxhirit. Fermerët vazhdimisht janë nën monitorimin e donatorëve apo edhe pikave grumbulluese ku ata shesin prodhimin e tyre. Kështu, duke menjanuar ngecjet që mund të shfaqen përgjatë procesit të prodhimit.

Me angazhimin e madh të donatorëve rrjeti i informacionit është përmirësuar shumë. Përmes konferencave, sesioneve informuese e broshurave shpërndarja e informacionit është bërë më e lehtë, nga prodhimi deri tek shitja. Përveq donatorëve rol shumë të madh po luajnë edhe pikat grumbulluese. Ato vazhdimisht mbledhin fermerët për koordinim sa më të mirë të punëve për

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

sezonën që po hyjnë. Secila pikë grumbulluese mbledh fermerët e vet për t'i shpalosur idetë rreth zhvillimit sa më të qëndrueshëm të mjedrës dhe dredhëzës.

Lidhje shumë të mira tregtare për eksport të mjedrës dhe dredhëzës Kosova ka krijuar me vendet fqinje por edhe me ato të BE-së. Me mjedër gjatë vitit 2018 janë eksportuar 1,714 tonë ndërsa më dredhëz të freskët rreth 90 tonë.

Gjatë vitit 2018-2019 Kosova ka eksportuar sasi të mëdha të këtyre kulturave drejtë Gjermanisë, Austrisë, Serbisë, Hungarisë e Zvicrës. Kurse ka importuar nga Polonia, Turqia, Belgjika, Holanda.

Koordinimi vertikal si sipas hulumtimit 46% del të jetë faktorë i kontrolluar nga vetë ferma, 29% nga qeveria dhe 25% faktorë i kontrolluar pjesërisht nga qeveria dhe ferma. Koordinimi horizontal në 37% të totalit të përgjigjeve thuhet se është faktorë i kontrolluar nga ferma dhe 16% nga qeveria. Ku nga kjo mund të konkludojmë se fermerët vet zgjedhin formën e koordinimit. Kurse qeveria mund të stimulojnë fermerët të prodhojnë sa më shumë përmes sigurimit të shitjes së prodhimit për fermerët fillestar.

4.2 Vërtetimi i hipotezave

Hipoteza 1

Kultura e mjedrës në krahasim me kulturën e dredhëzës ka marrë një hov më të madh të kultivimit vitet e fundit. E parë si një kulturë mjaft fitimprurëse dhe me kthim të shpejtë të investimeve sipërfaqja me mjedër është rritur ndjeshëm. Nga viti 2018 ku sipërfaqja e kultivuar me mjedër ishte 1537 ha, në vitin 2019 kjo sipërfaqe u rrit në 1637 apo me 6.5%. Tek dredhëza kemi ndryshim në vetëm 1 ha, ku nga 234 ha sa ishte në vitin 2018, u rrit në 235 në vitin 2019 apo 0.3%. Sa i përket kërkesës për eksport vlen të thuhet se të gjithë respondentët u përgjigjen se kërkesa për mjedër është më e madhe se ajo për dredhëz. Kjo kërkesë ka ndikuar që zinxhiri i vlerës të zhvillohet më shumë se ai i dredhëzës. Sot egzistojnë një numër i shoqatave të mjedrës të cilët po angazhohen që akterët e zinxhirit të vlerës tek kjo kulturë të kenë një koordinim sa më

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

të mirë. Shtytje në zhvillimin e ZV-së tek mjedra i kanë dhënë shtytje edhe projektet e ndryshme nga donatorët rreth trajnimeve të ndryshme.

Prandaj, nga të dhënat sasiore dhe cilësore mund të konkludojmë se zinxhiri i vlerës tek mjedra funksionon më mirë se tek dredhëza

Hipoteza 2

Për vërtetim të hipotezave të tjera të ngritura në këtë studim ne do të analizojmë kontributin e faktorëve si: kultura, inputet, menaxhimi në fermë dhe koordinimin e zinxhirit të vlerës.




Figura 12: Relevanca për nënfaktorët "inputet, menaxhimi në fermë dhe koordinimi i zinxhirit"

Burimi : Analizimi i të dhënave nga tereni

Koordinimi i zinxhirit mes akterëve të përfshirë në të ka dhënë një kontribut shumë të favorshëm në performancën e zinxhirit të vlerës tek mjedra dhe dredhëza. Forma më e shpeshtë e kontraktimit në shpërndarjen e produkteve në tërë vlerën zinxhirore mbeten kontratat me shkrim. Gjatë intervistës me pikat grumbulluese, ata treguan se kanë të nënshkruara kontrata me fermerët nga momenti kur ata u'a shpërndajnë fidanet atyre dhe se punojnë në bazë të tyre. Por, pavarësisht se nënshkruajnë kontrata fermerët në disa raste prishin marrëveshjen si arsye e ofrimit të shitjes së prodhimit nga dikush tjetër me çmim më të lartë, duke shkaktuar mungesë prodhimi tek pikat grumbulluese.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Pikat grumbulluese sot kanë arritur të krijojnë një rrjet të qëndrueshëm me fermerët e tyre. Meqenëse, fermerët kanë njohuri të pakëta rreth kultivimit sa më të mirë të dredhëzës dhe mjedrës, blerësit e tyre po i përkrahin ata në cdo kohë. Shumica e pikave grumbulluese gjatë hulumtimit në teren thanë se fidanet e mjedrës dhe dredhëzës i importojnë vet nga jashtë. Pas arritjes së fidavene në Kosovë fillojnë shpërndarjen e tyre tek fermerët me të cilët bashkëpunojnë. Me shpërndarjen e fidaneve ata ju mësojnë fermerëve praktikat më të mira të kujdesjes, ujitjes e trajtimit. Kjo mënyrë e integritit ka mundësuar lidhje më të fortë mes fermerit e pikës grumbulluese si dhe prodhim më cilësor.

Atëherë, duhet vërtetuar nëse koordinimi vertikal dhe horizontal kanë ndikim pozitiv në performancën e zinxhirit të vlerës përmes testimit me t-test.

Hipotezat janë:

Ho: Koordinimi vertikal dhe horizontal nuk kanë ndikim pozitiv në performancën e zinxhirit të vlerës

H1: Koordinimi vertikal dhe horizontal kanë ndikim pozitiv në performancën e zinxhirit të vlerës

Tabela 1: Analizimi i hipotezës së dytë me T-test

t-Test: One sample
Kordinimi vertikal

Mean	0.088730976
Variance	0.059417888
Observations	24
Hypothesized Mean	0
df	23
t Stat	1.783291234
P(T<=t) one-tail	0.043871247
t Critical one-tail	1.713871528
P(T<=t) two-tail	0.087742495
t Critical two-tail	2.06865761

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Për vërtetim të hipotezave duhet të fokusohemi në vlerat e t-testit dhe në vlerën e p-së. Në rastet kur t- testi tabelar më i madh se t-testi i llogaritur, atëherë pranohet hipoteza bazë dhe hudhet poshtë hipoteza alternative. Pastaj anasjelltas, kur t-testi tabelar më i vogël se t-testi i llogaritur, pranohet hipoteza alternative dhe hudhet hipoteza bazë. Tek koordinimi vertikal në rastin tonë vlera e t-testit të llogaritur është 1.78 dhe ajo e t-testit tabelar është 171. Me që vlera 1.78 është më e madhe se vlera 1.71 atëherë del se vlera e t-testit tabelar është më e vogël se vlera e t-testit të llogaritur.

Ose;

$$H_0: \mu \leq 0$$

$$H_1: \mu > 0 \quad 1.78 > 1.71 \text{ dhe vlera e p-së, } 0.04 < 0.05$$

Atëherë mbajmë hipotezën alternative dhe hudhim hipotezën bazë. Dhe themi se, ne jemi 95% të sigurt se koordinimi vertikal ka ndikim pozitiv në performancën e zinxhirit të vlerës tek sektori i pemëve të imëta.

Tabela 2 Testimi i hipotezës së dytë me T-test

t-Test: One sample
Kordinimi horizontal

Mean	0.115549188
Variance	0.079608201
Observations	24
Hypothesized Mean	0
Df	23
t Stat	2.006289565
P(T<=t) one-tail	0.028361901
t Critical one-tail	1.713871528
P(T<=t) two-tail	0.056723802
t Critical two-tail	2.06865761

Burimi : Analizimi i të dhënave nga terreni

T-testi i llogaritur tek koordinimi horizontal ka vlerë 2.0 kurse t-testi tabelar ka vlerë 1.71. Kurse vlera e p-së është 0.02 e cila është më e vogël se 0.05, cka tregon se koordinimi horizontal si

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

variabël ka rëndësi të madhe tek ZV-s. Pasi që t-testi i llogaritur është më i madh se t-testi tabelar atëherë konkludojmë se vlera 2.0 e t-testit të llogaritur gjendet jashtë intervalit të hipotezës H_0 . Prandaj me krahasimin e vlerave të t-testeve konkludojmë se ne mbajmë hipotezën H_1 dhe hudhim poshtë hipotezën H_0 .

Ose;

$H_0: \mu \leq 0$

$H_1: \mu > 0$ $2.0 > 1.7$ kurse vlera e p-së $0.02 < 0.05$

Themi se me një nivel të besueshmërisë prej 95% konstatojmë se koordinimi horizontal ka ndikim pozitiv në performancën e zinxhirit të vlerës tek ky sektor

Kështu duke përfundur se të dy koordinimet si ai vertikal edhe horizontal kanë ndikim pozitiv në performancën e zinxhirit të vlerës dhe se janë dy nënfaktorë tejet të rëndësishëm.

Inputet si faktorë gjithashtu dha një kontribut të favorshëm. Krahasuar me peridhën para 6 viteve sot fermerët nuk ballafaqohen me mungesë të inputeve. Qasja në fidane, pleh dhe produkte për mbrojtje të bimës (kimikate) janë të lehta. Furnizuesit kryesor të këtyre inputeve janë tregtarët e licencuar. Të gjitha inputet janë të importuara nga jashtë. Problemi me të cilët po ballafaqohet fermerët është mospërshtatja e fidaneve e në disa raste fidanet po arrijnë në Kosovë më sëmundje, si pasojë e moskontrollit të rregullt nga inspektorët fitosanitar në kufij.

Menaxhimi në fermë si faktorë në përgjithsi ka dhënë një kontribut të favorshëm në zinxhirin e vlerës. Ky kontribut vlerësohet të jetë në parametrat e tij pozitiv minimal. Ngecje e theksueshme shihet tek planifikimi i prodhimit dhe kontabiliteti. Përmirësim të gjendjes kemi tek menaxhimi i cilësisë, burimet e financimit të investimeve, bashkëpunimi mes akterëve të ZV-s dhe vendimmarrja.

Bashkëpunim i mirë brenda hallkave të zinxhirit është shfaq tek mjedra. Fermerët janë organizuar në grupe dhe organizata prodhuesish cka e ka përmirësuar gjendjen shumë. Gjithashtu egzistojnë shoqata të vogla nëpër regjione të cilat janë të bashkuara më shoqatën “Mjedra” e financuar nga USAID-i. Kjo shoqatë bashkon grupe fermerish që të marrin njohuri paraprake

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.

lidhur me kultivimin e mjedrës dhe ndihmën rreth grumbullimit dhe eksportimit të produktit. Kështu duke bërë një funksionim më të mirë të hallkave të vlerës zinxhirore.

Hipoteza 3




Figura 13: Relevanca tek faktori "Politikat bujqësore"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga tereni

Politikat bujqësore parashohin mbështetjen e sektorit të pemëve të imëta me qëllim rritjen e të ardhurave, rritje të konkurrencës, parandimi të migrimit. Sektori i pemëve të imëta është i mbështetur përmes grandeve dhe pagesave direkte. Skema e përkrahjes për pagesa direkte te ky sektor bëhet në bazë të prodhimit. Kurse, grandet ky sektor përkrahët në kuadër të masave 101 dhe 103 deri në 65%.

Atëherë testojmë hipotezën me anë të t-testit për të parë nëse politikat bujqësore kanë ndikim pozitiv në performancën e zinxhirit të vlerës.

Hipotezat janë:

H₀: Politikat bujqësore nuk ndikojnë pozitivisht në performancën e zinxhirit të vlerës tek mjedra dhe dredhëza

H₁: Politikat bujqësore ndikojnë pozitivisht në performancën e zinxhirit të vlerës tek mjedra dhe dredhëza

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Tabela 3: Testimi i hipotezës së tretë me T-test

t-Test:One sample	
<i>Politikat bujqesore</i>	
Mean	0.054777163
Variance	0.010062132
Observations	24
Hypothesized Mean	0
df	23
t Stat	2.675224014
P(T<=t) one-tail	0.006758377
t Critical one-tail	1.713871528
P(T<=t) two-tail	0.013516754
t Critical two-tail	2.06865761

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Atëherë ne vijmë në konkludim se në bazë të t-testit ne pranojmë hipotezën alternative. Hipoteza alternative thotë se politikat bujqësore ndikojnë pozitivisht në performancën e zinxhirit të vlerës tek mjedra dhe dredhëza. Vërtetimin mund ta bëjmë edhe përmes vlerës së p-së, ku vlera e p-së në rastin tonë është 0.006. Meqenëse, 0.006 më e vogël se 0.05 atëherë hudhim poshtë hipotezën bazë dhe pranojmë hipotezën alternative

Ose;

$$H_0: \mu \leq 0$$

$$H_1: \mu > 0 \quad 2.67 > 1.71 \text{ dhe vlera e p-së } 0.006 < 0.05$$

Ne jemi të sigurtë 95% se politikat bujqësore kanë ndikim pozitiv në performancën e zinxhirit të vlerës. Nga krejt kjo vijmë në përfundim se përkrahja përmes subvencioneve dhe granteve nga ana e qeverisë ka ndikuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave, rritje të konkurrencës, shtim të prodhimit dhe parandalim të migrimit nga zonat rurale.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.

Hipoteza 4

Tabela 4: Testimi i hipotezës së katërt me T-test

t-Test: One sample

Teknologjia

Mean	0.358229342
Variance	0.384652647
Observations	24
Hypothesized Mean	0
df	23
t Stat	2.829647999
P(T<=t) one-tail	0.004749614
t Critical one-tail	1.713871528
P(T<=t) two-tail	0.009499229
t Critical two-tail	2.06865761

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Hipoteza e fundit e përfshirë në hulumtim është rreth teknologjisë së përdorur. Testimi bëhet për të parë ndikimin e bujqësisë tradicionale në prodhimtarinë e mjedrës dhe dredhëzës.

Hipotezat e ngritura janë:

Ho: Teknologjia e përdorur në vend nuk ndikon në prodhimtarinë e mjedrës dhe të dredhëzës

H1: Teknologjia e përdorur në vend, ndikon në prodhimtarinë e mjedrës dhe të dredhëzës

Me krahasimin e t-testeve në model arrijmë në përfundim se t-testi tabelar është më i madh se t-testi i llogaritur. Dhe në këtë rast, ne hudhim poshtë hipotezën bazë dhe mbajmë hipotezën alternative. Gjithashtu vlera e p-së në model, e cila është shumë më e vogël se 0.05 tregon se bujqësia tradicionale si variabël është e rëndësishme në prodhimtarinë e mjedrës dhe dredhëzës.

Ose;

H0: $\mu \leq 0$

H1: $\mu > 0$, $2.82 > 1.71$ kurse vlera e p-së 0.004

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Me 95% nivel të besueshmërisë ne themi se teknologjia ndikon në prodhimtari prandaj duhet bërë përpjekje të vazhdueshme të adaptimit të teknologjisë së re, sidomos tek fermerët.

KAPITULLI 5 : PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1 Përfundime

Sektori i pemëve të imëta ka marrë vëmendjen e qeverisë në dekadën e fundit. Fermerët janë më shumë të koncentruar në kultivimin e mjedrës se sa të dredhëzës. Kërkesa për eksport të mjedrës ka ndikuar në rritje të sipërfaqes së kësaj kulture vit pas viti. Dredhëza është e destinuar kryesisht për tregun e brendshëm dhe pak eksportohet. Rritja e vazhdueshme e kërkesës për mjedër dhe dredhëz në vendin tonë ka ndikuar në rritje të importit, sidomos jashtë sezonave të kultivimit. Kultivimi i mjedrës u prezantua nga projektet e zhvillimit si kulturë me kthim të shpejtë të investimeve. Ofrimi i mirë i kushteve të tregut dhe gjetja e lehtë e tyre ka bërë që këto kultura të shihen me mjaft interes nga ana e fermerëve.

Sa i përket tregut ndërkombëtar, Kosova ende nuk e ka parë efektin e tyre të plotë. Dhe se, sipas këtij hulumtimi të bërë në teren korrespondojnë gjendja e zinxhirit të vlerës si para antarësimit nëpër organizata evropiane si pas antarësimit ishte pothuajse e njëjtë.

Madhësia e fermës tek mjedra dhe dredhëza vazhdon të jetë problem tjetër që shoqëron vlerën zinxhirore. Fermerët që kultivojnë këto kultura përbëhen nga madhësi të vogëla të fermës. Tek ky sektor kemi pasur rritje të numrit të fermerëve që kultivojnë këto kultura por jo edhe zgjerim të sipërfaqeve të parcelave egzistuese. Rritje të madhësisë së fermës kemi pasur vetëm në rastet kur fermeri ka qenë përfitues i ndojnë grandit nga ministria.

Nuk bëhet monitorim i vazhdueshëm i tokës. Analizat e tokës kryhen vetëm në rastet kur produkti është i destinuar për eksport, kurse kur destinohet për treg të brendshëm nuk kryhen analiza. Fermerët nuk kanë probleme me sigurimin e fidaneve nga jashtë, por po hasin probleme tek përshtatshmëria e varietetit. Fidanet e importuara kanë vështirësi në përshtatje të tokës si pasojë e moskryerjes së analizave në kufij kur ato hyjnë në vendin tonë. Dhe si pasojë e kësaj fermerët janë ballafaquar me humbje të larta në prodhim ku rimëkëmbja ka qenë e vështirë për ta.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

Lidhjet tregtare të sektori i pemëve të imëta qëndrojnë mjaft mirë. Mjedra e Kosovës vazhdon të zgjerojë praninë e saj në tregje të ndryshme evropiane kështu duke bërë konkurrencë me vendet që kanë traditë në kultivimin e saj. Lidhje të mira paraqiten edhe mes fermerëve dhe pikave grumbulluese. Këto dy akterë vazhdimisht po ndajnë praktikën më të mirë me njëra tjetrën rreth prodhimit dhe përpunimit të produktit. Thënë më shkurt kanë krijuar një rrjet të fortë bashkëpunimi.

Fermerët po përballen me mungesë në qasje në financa, normat e interesit vazhdojnë të jenë ende të larta ndërsa periudhat e pushimit të papërshtatshme. Fermerët kanë pak njohuri rreth rëndësisë së mbajtjes së kontabilitetit në fermë. Ata nuk mbajnë shënime financiare dhe nuk kryejnë asnjë analizë ekonomike. Kjo vjen nga fakti që fermerët janë shtresa me nivel të ulët të arsimit dhe vështirësitë në përshtatje rreth aspektit të mbajtjes së të hyrave dhe të dalurave në fermë janë të mëdha. Ata gjithashtu ngurrojnë të paguajnë persona adekuat për mbajtjen e shënimeve të fermës.

Forma e koordinimit vertikal e ka shoqëruar vazhdimisht këtë sektor. Marrëveshjet fermerë, pikë grumbulluese dhe mes tregtarëve kanë qenë kontratat me shkrim. Por, gjatë hulumtimit në teren kemi vërejtur se edhe koordinimi horizontal është mjaft prezent në vlerën zinxhirore. Tek mjedra dhe dredhëza vërejmë një integrim më të madh të fermerëve nëpër shoqata dhe bashkëpunim të mirë mes tyre rreth shpërndarjes së praktikave. Janë mbajtur vazhdimisht trajnime nga ana e donatorëve në bashkëpunim me shoqatat.

5.2 Rekomandime

Pavarësisht se zinxhiri i vlerës funksionon mirë, ende mbesin disa aspekte për tu dëshiruar. Nevoja për intervenim është më se e nevojshme për funksionim dhe koordinim sa më efikas të vlerës zinxhirore tek ky sektor. Më poshtë janë paraqitur disa rekomandime të cilat pas kryerjes së hulumtimit i kam identifikuar se duhet të intervenohet.

Rekomandohet:

- Stimulimi i inkuadrimin të fermerëve të rinjë në kultivimin e mjedrës dhe dredhëzës, me qëllim rritjen e prodhimit, përmbushjen e kërkesave të brendshme dhe parandalimin e importit jashtë sezonave.
- Rritja e ndërgjegjësimit në menaxhimin e vazhdueshëm të cilësisë, sigurinë e ushqimit tek prodhuesit primarë.
- Ofrimi i trajnimeve për fermerët nga qeveria dhe donatorë rreth mbajtjes së shënimeve në fermë për fermerët. Kjo të bëhet me qëllim të shmangjes së prodhimit me humbje dhe identifikimin e pikave për përmirësim sa më të shpejtë.
- Promovimi i kontratave afatgjatë pasi që një pjesë e akterëve ende kryejnë kontraktimin e prodhimit pa kontrata. Kështu do të bëhej krijimi i lidhjeve më të mira mes fermerëve, pikave grumbulluese dhe tregtarëve në aspektin e komunikimit dhe transparencës.
- Vazhdimi i promovimit të bashkëpunimit horizontal për krijimin e marrdhënieve edhe më të afërta mes akterëve të hallkave zinxhirore
- Qasje më e lehtë në shërbime dhe financa. Qasje në kredi të buta dhe ulje të normave të interesit në sektorin e bujqësisë
- Stimulimi i rritjes së prodhimit me qëllim të rritjes së konkurrencës në vend
- Rekomandohen të kryhen kontrolla më të shpeshta sanitare dhe fitosanitare në ferma dhe kompani me qëllim përmirësimin e zinxhirit të vlerës tek mjedra dhe dredhëza.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

LITERATURA

- 1) Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. (2017). *Rruga e Kosovës drejtë Integritimit Ekonomik Evropian*. Prishtine.
- 2) ASK. (2017). *Pemëtaria në Republikën e Kosovës*. Retrieved from ASK: <https://ask.rks-gov.net/media/3176/pem%C3%ABtarija-n%C3%AB-republik%C3%ABn-e-kosov%C3%ABs.pdf>
- 3) Bajramović, S., Bogdanov, J., Butkovic, J., Dimitrievski, D., Erjavec, E., Gjeci, G., Hoxha, B., Janeska, I., Konjevic, D., Kotevska, A., Matrinovic, A., Miftari, I., etj. (2016). Analysis of the agricultural and rural development policies of the Western Balkan countries. 1-132.
- 4) Bolwig, S., Ponte, S., Toit, A., Riisgaard, R., Halberg, N. (2008). Integrating poverty, gender and enviromental concerns into value chain analysis. *A conceptual framework and lessons for action research*, 1-70.
- 5) David Neven. (2014). *Developing sustainable food value chains, Guiding principles*. FAO, Food and Agriculture Organization of the United Nations.
- 6) EFSE, Europe, European fund for southeast Europe. (n.d.). *FINANCIMI BUJQËSOR NË KOSOVË*.
- 7) FAO, Food and Agricultural Organization. (2011). *A value chain approach to animal diseases risk managment*.
- 8) FAO, food and Agriculture Ogranization. (2007). *Guidelines for rapid appraisals of agrifood chain performance in developing countries*.
- 9) Food Agriculture Organization of the United Nations. (2013). *Guidelines for value chain analysis in the agri-food sector of transitional and developing economies*. Retrieved from http://www.fao.org/tempref/AG/Reserved/PPLPF/Docs/Reports%20&%20Papers/GUI_MT_GL_JO_04_Value%20Chain%20Analysis_ESSEC.pdf
- 10) Food and Agriculture Organization of the United Nations. (2015). *Politika Bujqësore dhe Integritimi Evropian në Evropën Juglindore*. Regional Rural Development Standing Working Gropu.
- 11) Gjokaj, E. Halimi, K. Gjonbalaj, M. Leeds, S. (2017). *Agricultural Finance in Kosovo*. Retrieved from Economic Alternatives: https://www.unwe.bg/uploads/Alternatives/Kosovo_ea_en_br_1_2017-4.pdf
- 12) Gjokaj, E., Halimi, K., Xhabali, V., Imami, D., Gjonbalaj, M. (2017, February). Fruits value chain and distribution channels in Kosovo. *I(23)*, 22-30.

- B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*
- 13) Gjokaj, E, Gjonbalaj, M, Halimi, K, Leeds, S. (2018). Agriculture Finance in Kosovo. (1), 79-88.
 - 14) Instituti për studime të avancuara- GAP. (2011). *Kosova në BE*. Institucioni GAP.
 - 15) Kaplinsky, R. (n.d.). Spreading the gains from globalisation: What can be learned from value chain analysis? *IDS Working Paper110*, 1-37.
 - 16) Kaplinsky, R., Morris, M. (2014). A handbook for value chain research. *An Important Health Warning or a Guide for Using this Handbook*, 1-113.
 - 17) Kumar, D., Rajeev, P.V. (2016). Value Chain: A Conceptual Framework. *International Journal of Engineering and Management Sciences*, 7(1), 74-76.
 - 18) Lampiotti, J., Lugg, D., Van der Celen, P., Branczik, A. (n.d.). *The Changing Face of Rural Space- Agriculture and rural development in the western balkans*. The World Bank.
 - 19) MBPZHR. (2009). *Strategjia për hortikulturë e Kosovës 2009-2013*. Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Republika e Kosoves.
 - 20) MBPZHR. (2017). *Raporti i gjelbër 2017*. Prishtinë: MBPZHR.
 - 21) MBPZHR. (2018). *Raporti i gjelbër 2018*. Prishtinë: MBPZHR.
 - 22) MBPZHR. (2019). *Analiza e tregut të mjedrës*. Prishtinë: MBPZHR.
 - 23) MBPZHR. (2019). *Raporti i gjelbër 2019*. Prishtinë: MBPZHR.
 - 24) MBPZHR. (2020). *Analiza e tregut të dredhëzës*. Prishtinë: MBPZHR.
 - 25) MBPZHR. (2020). *ÇMIMET E PRODUKTEVE BUJQËSORE NË KOSOVË 2018-2019*. Prishtinë: MBPZHR.
 - 26) Miftari, I. (2016). *Përmbledhje e raportit për zinxhirin e vlerës*. Prishtina: FAO Regional Office for Europe and Central Asia.
 - 27) Miftari, I. (2019). *Zinxhiri i vlerës në sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë*. Prishtinë: PePeKo.
 - 28) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. (2020). *ANALIZA PËR IMPORTIN E PRODHIMEVE BUJQËSORE 2017-2019*. Prishtine: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
 - 29) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. (2020). *Raporti i gjelbër 2020*. Prishtinë: MBPZHR.
 - 30) Mitchell, J., Keane, J., Coles, Ch. (2009). Trading up: How a Value Chain Approach Can Benefit the Rural Poor. 1-94.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. *Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.*

- 31) MTI, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. (2017). *Efektet e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit Kosovë - BE: Ndikimi në Tregti*. Retrieved from MTI, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
- 32) Muriqi, M., Fekrete-Farkas, M., Baranya, Z. (2019, 02). Drivers of cooperation activity in Kosovo's agriculture. *1*, 1-12.
- 33) Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. (n.d.). *Politikat në fokus: Tregtia*. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.
- 34) Porter, M. (n.d.). *Five Forces Model*.
- 35) Recklies, D. (2001). *The value chain*. Retrieved from FAO:
http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/fisheries/docs/ValueChain.pdf
- 36) Soosay, C., Fearne, A., Dent, B. (2012). Sustainable value chain analysis- a case study of Oxford Landing from "vine to dine". *Supply Chain Management: An International Journal*, 17(1), 68-77.
- 37) Townsley, P. (1993). *RAPID APPRAISAL METHODS FOR COASTAL COMMUNITIES*. Bay of Bengal Programme.
- 38) Trienekens H, J. (2011). Agricultural Value Chains in Developing Countries, A Framework for Analysis. *International Food and Agribusiness Management Association*, 14(2), 1-32.
- 39) University of Cambridge. (2020). Value Chain Definitions and Characteristics. 1-4.
- 40) Vondal, P. (2010). PERFORMANCE MONITORING & EVALUATION TIPS USING RAPID APPRAISAL METHODS. 2(5), 1-6.

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.

ANEKS

Faktorët dhe nënfaktorët	Kontrollueshmëria				Relevanca		Pesha	Vlerësimi i faktorit
	FKF	FKQ	FPK	FP				
Tregu ndërkombëtarë								
MSA								
CEFTA								
Barrierat jo-tarifore								
Barrierat tarifore								
Tregjet me vendet e tjera								
TOTAL								
R&D (Kërkim dhe Zhvillim)								
Fuqia punëtore e specializuar								
Organizata të specializuara hulumtuese								
TOTAL								
Kulturat (mjedër dhe dredhëz)								
Cilësia e tokës								
Analizat e tokës								
Klima								
Madhësia e fermës								
TOTAL								
Ambienti								
Ekonomik, Tregtar								
Social								

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.

Natyror								
Gruaja në biznes (të drejtat e pronës)								
TOTAL								
Pajisjet								
Teknologjia e përdorur								
Asistenca teknike (ekspertiza)								
TOTAL								
Inputet								
Fidanet								
Plehu								
Karburantet, Uji dhe E. Elektrike								
Produktet e mbrojtjes së bimes (kimikatet)								
Shërbimet këshillimore private								
Shërbimet këshillimore publike								
TOTAL								
Fuqia punëtore								
Kualifikimi								
Pervoja								
Trajnimet per stafin								
TOTAL								

B. Vahapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.

Struktura e tregut								
Tregu vendor								
Tregu rajonal								
Kontratat/Kushtet e pagesës								
Komercializimi/Shitja								
TOTAL								
Menaxhimi në fermë								
Planifikimi i prodhimit								
Menaxhimi i cilësisë								
Kontabiliteti në fermë								
Burimet e financimit të investimeve								
Bashkëpunimi me akterët e ZV								
Vendimmarrja								
TOTAL								
Makroekonomia								
Lehtësia e perfitimit të kredise								
Norma e interesit								
Periudha e pushimit (Grace)								
Hipoteka								
Inflacioni								
Të ardhurat								
Taksa në imputet e importuara								
Madhësia e tregut								
Konkurrenca								

B. Vehapi: Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve të imëta: mjedër dhe dredhëz në Kosovë. Punim i temës së Masterit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, 2021.

Kapaciteti i eksportit								
Madhësia e importit								
Politikat bujqësore								
TOTAL								
Rregullativa e Sigurisë Ushqimore								
HACCP								
ISO								
GLOBAL GAP								
BIO								
TOTAL								
Inspektimi								
Sistemi i shërbimit të inspektimit								
Inspektimi Sanitar/Fitosanitar								
TOTAL								
Koordinimi i zinxhirit								
Koordinimi vertikal								
Koordinimi horizontal								
Rrjeti i informacionit								
Lidhjet tregtare								